



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT STUDIMOR

MONITORIMI I PROCESIT TË VETTINGUT
TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË PERIU DHËN
JANAR 2017 – QERSHOR 2018



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT STUDIMOR

MONITORIMI I PROCESIT TË VETTINGUT
TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË PERIU DHËN
JANAR 2017 – QERSHOR 2018



Ky publikim realizohet në kuadër të projektit “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut” – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqiptari (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH).



Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Përgatitën raportin:

Av. Erida Skëndaj - Drejtore Ekzekutive e KShH-së

Av. Fjoralba Caka - Eksperte e Jashtme

Prof. Asoc. Mirela Bogdani

Konsulencë:

Z. Niazi Jaho - *Këshilltar Ligjor*

Asistencë Ligjore:

Av. Elton Frashëri – *KShH*

Autor: © **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana, Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: +355 4 2233671 Cel: +355 69 40 75 732

<https://www.facebook.com/KomitetishqiptariHelsinkit>

E-mail: office@ahc.org.al;

www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
3. GJETJET KRYESORE	13
3.1 Konkluzione të përgjithshme	13
3.2 Arsyet e vonesave në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë	15
3.3 Ndikimi i vonesave në drejtim të aksesit në drejtësi të qytetarëve	17
3.4 Pengesat dhe vonesat në punën e organeve ndihmëse	17
3.5 Procedurat parlamentare për për zgjedhjen e kandidatëve për anëtar në organet e vettingut	19
3.6 Aktet nënligjore të organeve të vettingut	19
3.7 Pagat, buxheti dhe personeli i organeve të vettingut	21
3.8 Transparenca e organeve ndihmëse dhe ballafaqimi i të dhënave të tyre	22
3.9 Transparenca e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit	24
3.10 Shortimi i subjekteve të vettingut	25
3.11 Subjektet e dorëhequra	26
3.12 Afati i dorëheqjes	27
3.13 Dorëheqja pranë organit të përcaktuar me ligj	28
3.14 Përmbajtja dhe forma e vendimit të ndërprerjes së vettingut (dorëheqjet)	29
3.15 Ritmet e seancave dëgjimore në KPK	29
3.16 Transparenca e KPK-së	31

3.17 Bashkëpunimi dhe përfshirja e publikut në procesin e vettingut	33
3.18 Respektimi i dinjitetit njerëzor të gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve)	36
3.19 Aksesit në infrastrukturë dhe dokumentacion	37
3.20 Solemniteti, Paanshmëria dhe Etika e Trupave Gjyqësore të KPK-së	38
3.21 Publiciteti i seancave të zhvilluara nga KPK dhe KPA	39
3.22 E drejta për t'u mbrojtur (efektiviteti) dhe për tu dëgjuar (kontradiktoriteti)	41
3.23 Monitorimi i Vendimeve të KPK (pikëpamja logjistike)	42
3.24 Standardet dhe qartësia e arsytimit të vendimeve nga KPK	43
3.25 Vendimmarrja për një kriter a presupozon që të mos përfundojë vettingu për dy kriteret e tjera?	45
3.26 Standardi i analizës së kriterit të pasurisë në vendimet e KPK-së	46
3.27 Mospërputhja e të dhënave të organeve ndihmëse me të dhënat e hetimit administrativ të KPK (referuar analizës së vendimeve të KPK-së)	47
3.28 Vendimmarrja e KPK-së (konfirmimet/shkarkimet)	48
3.29 Kallëzimet në prokurori nëse gjatë vettingut zbulohen të dhëna/fakte/prova që përbëjnë vepër penale	50
4. REKOMANDIME	51

1. HYRJE

Të dashur lexues,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka vlerësuar si tepër të rëndësishme për qytetarët, procesin e hartimit dhe të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë.

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ose siç njihet ndryshe vettingu, është një nga masat më të rëndësishme reformuese të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Vettingu është konsideruar nga Komisioni i Venecias si masë e jashtëzakonshme, tranzitore dhe e nevojshme në kushtet e Shqipërisë. Modeli i tij është unik për Shqipërinë dhe do të realizohet vetëm një herë.

Procesi i vettingut ka mbërritur në fazën kur ka dhënë rezultatet e para konkrete, duke bërë të mundur që të fillojnë të ndihen në praktikë, efektet e zbatimit të reformës në drejtësi. Duke pasur në konsideratë interesin publik të këtij procesi por gjithashtu respektimin e të drejtave të gjyqtarëve dhe prokurorëve që do ti nënshtrohen atij, KShH ndërmori një nisëm monitoruese të vettingut që në hapat e para të zbatimit të kornizës ligjore të tij.

Monitorimi u krye nga ekspertë vendas, me përvojë dhe integritet të lartë profesional, juristë të specializuar në të drejtë kushtetuese, të drejtë publike, administrative, në fushën e avokatisë etj. Grupi i ekspertëve vendas u ndihmua nga dy ekspertë ndërkombëtarë të fushës si dhe u asistua nga stafi i KShH-së.

Ky monitorim, i pari i këtij lloji nuk ka qenë i lehtë. Megjithatë ai na ka shërbyer për punën tonë, në mënyrë të veçantë në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të një metodologjie sa më efektive dhe profesionale të monitorimit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të vettingut.

Përgjatë gjithë procesit të monitorimit, KShH ka informuar publikun dhe median mbi gjetjet dhe konkluzionet kryesore të tij, të cilat, në disa raste, kanë kontribuar në mënyrë modeste për një transparencë dhe publicitet më të lartë të procesit.

Gjithashtu, KShH ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me organet e vettingut, në sajë të bashkëpunimit të të cilave ka mundur të konsultojë aktet rregullatore të

këtyre institucioneve si dhe të marrë sugjerimet dhe opinionet e tyre për gjetjet dhe rekomandimet e prezantuara në këtë raport përfundimtar monitorimi, disa prej të cilave i kanë shërbyer pasurimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të tij.

Gjetjet dhe rekomandimet e pasqyruara në këtë raport shpresojmë të vijojnë të kontribuojnë në mënyrë modeste në rritjen e efikasitetit të zbatimit të legjislacionit të vettingut dhe rritjen e besimit të publikut në këtë proces. Në çdo rast, këto gjetje dhe rekomandime nuk duhet të konsiderohen si të detyrueshme apo si ndërhyrje në veprimtarinë e organeve të vettingut, të cilat janë të pavarura dhe ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr.84/2016.

Në përfundim dëshiroj të falënderoj për kontributin dhe profesionalizmin, ekspertët dhe monitoruesit e angazhuar në këtë proces, Shoqatën e Prokurorëve Serbë si dhe stafin e KShH-së.

Gjithashtu, një falënderim i veçantë shkon për stafin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë për angazhimin profesional dhe bashkëpunimin konstruktiv përgjatë gjithë procesit të zbatimit të kësaj nisme.

Sinqerisht,

Erida Skëndaj

Drejtoreshë Ekzekutive

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas dy viteve nga miratimi i reformës në sistemin e drejtësisë, me përjashtim të procesit të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kuadri i ri ligjor i drejtësisë ende nuk po zbatohet. Vettingut i janë nënshtruar një numër relativisht i pakët subjektsh, ndërkohë që ritmet e procesit kanë qenë të ngadalta deri në fund të muajit Maj dhe janë përshpejtuar disi në muajin Qershor të këtij viti. Institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë nuk janë ngritur ende dhe rrjedhimisht nuk funksionojnë.

Ngritja dhe funksionimi i institucioneve të vettingut është shoqëruar me disa vonesa, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në funksionimin e një sërë institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Vonesat në ngritjen e institucioneve të tjera të reja të drejtësisë¹ kanë reflektuar negativisht gjithashtu edhe në funksionimin e institucioneve ekzistuese, të cilat kanë kompetenca më të kufizuara deri në ngritjen e institucioneve të reja. Gjithashtu, kjo situatë **ka krijuar probleme në drejtim të aksesit në drejtësi dhe efikasitetin** së gjykimit, veçanërisht në Gjykatën e Lartë, ku për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve si dhe dosjeve të mbartura ndër vite, aktualisht ka rreth 23,900 dosje të qytetarëve që presin në radhë për tu gjykuar.

Gjykata Kushtetuese këto dy-tre muajt e fundit është jo funksionale dhe lind nevoja për të zhbllokuar ngërçin që është krijuar në plotësimin e vakancave në këtë gjykatë. Për shkak të rezultateve të paparashikueshme të procesit të vettingut deri më tani, me shkarkimin e një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të gjykatave më të larta, zbatimi i reformës në drejtësi ka pësuar ngërç, i cili është i nevojshëm të zhbllokohet në interes të publikut dhe qytetarëve. Një pjesë e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë janë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, institucioni që është ngarkuar me kompetenca për të përzgjedhur anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese (neni 149/d, paragrafi 3 i Kushtetutës). **Situata aktuale dikton një nevojë të menjëhershme dhe prioritare për të rivlerësuar anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mandati i të cilëve është i kufizuar për një vit. KED nuk mund të funksionojë me anëtarë që nuk janë konfirmuar nga procesi i vettingut.** Neni 221/7 i ligjit nr.115/2016 për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë parashikon përzgjedhjen e anëtarëve zëvendësues, të cilët po ashtu

1 Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

duhet ti nënshtrohen vettingut. Sipas nenit 229/3 të ligjit 115/2016, KED mund të funksionojë me prezencën e të paktën pesë anëtarëve që e kanë kaluar vettingun, ku vendimet merren me shumicën e tyre. **Deri në fund të muajit Qershor, KPK ka konfirmuar në detyrë vetëm një kandidat për KED, ndërkohë që dy prej këtyre kandidatëve janë shkarkuar dhe për një prej tyre vettingu është ndërprerë për shkak të dorëheqjes.**

Kandidatët për anëtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë nuk janë subjekt i vettingut. Sikurse theksohet më sipër, vetting është i përkohshëm dhe subjektet që i nënshtrohen atij ex-officio (për shkak të ligjit), janë ata që ushtrojnë detyrën gjatë kohës së hyrjes në fuqi të ligjit të vettingut dhe rivlerësimi nuk i shtrin efektet për anëtarët e rinj që do të pranohen në sistemit gjyqësor. Subjektet që e kalojnë vettingun i nënshtrohen një sistemi të përhershëm të llogaridhënies. Këtij sistemi të përhershëm i nënshtrohen gjithashtu edhe gjyqtarët dhe prokurorët e rinj që do të emërohen në pozicione të ndryshme brenda sistemit (në nivele të ndryshme të tij).

Në këtë situatë, edhe pse efektet e reformës po ndihen në drejtim të vettingut, sistemi i drejtësisë po punon në mënyrë të sforcuar deri në rikthimin e tij në identitetin që kjo reformë synon në interes të qytetarëve, për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për një sistem drejtësie të pavarur, eficient, profesional, llogaridhënës dhe të përgjegjshëm.

Procesi i vettingut ka pasur jehonë pozitive dhe ka ngjallur interes dhe besim tek publiku. Deri në maj të këtij viti (2018), nga publiku ka pasur 736 denoncime ose ankesa në total për subjektet e vettingut (gjyqtarë apo prokurorë). Referuar vendimeve të deritanishme të KPK-së rezulton se këto ankesa janë hetuar administrativisht dhe i janë komunikuar subjekteve të vettingut. Numri i lartë i ankesave të qytetarëve është tregues i besimit të publikut tek procesi dhe institucionet e vettingut që po e zbatojnë atë. Megjithatë, vlen të evidentohet se **nga komunikimi që kemi pasur me disa qytetarë të cilët rezultojnë se kanë denoncuar pranë KPK-së, ata referojnë se nuk kanë marrë informacion se çfarë është bërë me ankesat e denoncuar prej tyre, nëse ka pasur ose jo një hetim administrativ dhe nëse KPK ka pasur nevojë për informacione apo dokumentacione shtesë lidhur me këto ankesa.** Gjithashtu, vërehet se qytetarët ende nuk po ushtrojnë një mekanizëm tjetër të parashikuar në ligj, atë të kërimit të statusit të bashkëpunëtorit të drejtësisë, edhe pse ndaj tyre ligji parashikon favorizime monetare.

Vetting ka pasur disa momente për tu ndalur në optikën vëzhguese të KShH-së, siç ishin dëgjesat e zhvilluara nga komisionet parlamentare *ad hoc* për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar në organet e vettingut. 20 % nga 84 kandidatët në këto institucione që u dëgjuan nga Komisioni i parë parlamentar ad hoc i verifikimit morën paraprakisht rekomandime negative nga ONM-ja, për çështje që lidhen me konfliktin e interesit dhe të pasurive të pajustificuara të këtyre kandidatëve. Megjithatë, ky komision parlamentar pranoi se këta kandidatë plotësonin kriteret formalo – ligjore. Gjatë këtyre seancave dëgjimore u vërejtën elementë të formalizmit apo edhe raste të polarizimit politik. Një numër kandidatësh të formuar dhe me eksperiencë të konsiderueshme jashtë vendit u s’kualifikuan sepse nuk plotësonin formalisht kriteret ligjore.

Një problem për tu ndalur ishte mungesa e transparencës ndaj publikut nga ana e organeve ndihmëse të vettingut në këtë proces (DSIK dhe ILDKPKI). Pavarësisht nga vendimmarrja pozitive e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, mekanizmat ligjorë të ligjit për të Drejtën e Informimit nuk kanë qenë efektiv për të mundësuar dhënien e informacionit nga këto organe ndihmëse. Megjithatë, ndjekja nga KShH e rastit në rrugë gjyqësore shënoi disa suksese në drejtim të rritjes së transparencës së këtyre organeve, të cilat në mënyrë të ndryshme, dhanë informacionin e kërkuar për publikun.

Transparenca e veprimtarisë së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është një aspekt i diskutueshëm i procesit, pasi publiku dhe media kufizohet vetëm në marrjen e informacionit gjatë seancës dëgjimore, kur vëzhgues të ONM-së kanë pyetje për subjektet e vettingut.

Ndërkohë, transparenca e të tri organeve të vettingut mund të themi se ka qenë në nivele të kënaqshme dhe është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme me anë të faqeve të tyre zyrtare, ku janë publikuar informacione për çështjet, seancat dëgjimore, ankimet, vendimet si dhe ka pasur njoftime të herëpashershme për shtypin dhe publikun lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre.

Për disa nga gjetjet dhe rekomandimet në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit kanë paraqitur observacionet dhe mendimet e tyre. Këto observacione janë reflektuar në pjesët përkatëse të këtij raporti përfundimtar, të cilat bëjnë një analizë më të detajuar të vlerësimeve të KShH-së dhe të qëndrimeve të organeve të vettingut.

Në rastin e vendimeve të shkarkimeve të deritanishme, është vërejtur në disa prej tyre se KPK ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin vetëm mbi kriterin e pasurisë, duke mos përfunduar dhe duke mos marrë në konsideratë hetimet mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale. Kushtetuta e RSH parashikon që procesi i vettingut kërkon kontroll të të tri komponentët që qëndrojnë në themel të tij. Pavarësisht nga formulimi i bërë në nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, kemi mendimin se procesi nuk do të ishte i plotë dhe as transparent për publikun nëse subjektet nuk i nënshtrohen të trja filtrave të kontrollit.

Një nga çështjet e diskutuara publikisht është nëse vlerësimi i pasurisë është ose jo shumë strikt nga institucionet e vettingut ose nëse ky standard strikt kërkohet ose jo, çka mund të vendosë subjektet e vettingut në pozita dështimi për ta kaluar procesin. Vettingu synon largimin e gjyqtarëve/prokurorëve të korruptuar (por jo në aspektin penal), ku një nga indikatorët është pasuria e akumuluar në mënyrë të pashpjegueshme. Pyetja që shtrohet është se në ç'masë do të konsiderohen të arsyeshme mungesat në dokumentacion, mungesat e provave për veprimtaritë para 20 viteve, shkeljet e legjislacionit financiar në fushën e tatim-taksave, bankës, regjistrimit të pasurive, etj.? Ndryshimet në ligjet fiskale dhe financiare, ekonomia informale sidomos në vitet e para të demokracisë, mungesa e detyrimit për ruajtjen e faturave kur kjo nuk kërkohet detyrimisht nga legjislacioni financiar si dhe fakti që institucionet shtetërore kanë një periudhë të caktuar për ruajtjen e dokumentacionit financiar, mund të kenë krijuar vështirësi për subjektet që të provojnë mënyrën e fitimit të pasurisë, veçanërisht para miratimit të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë". Kjo është një çështje që kërkon trajnim të specializuar të organeve të vettingut. Sipas nenit 19 të ligjit të vettingut, organet duhet të kenë buxhetin e tyre, me qëllim që të plotësojnë edhe kërkesat apo nevojat e tyre për trajnim.

Seancat dëgjimore të monitoruara pranë KPK-së reflektuan një nivel të lartë solemniteti, i cili u vërejt që në aspektin logjistik, komunikimin e realizuar nëpërmjet koordinatorit të medias dhe publikut, në mënyrën e organizimit të sallës, në sjelljen e trupës së vettingut karshi subjekteve dhe mbrojtësve të tyre, etj.

Për median dhe publikun që kishte interes për të ndjekur këto seanca dhe paraqitej në sallë para çeljes së tyre, seanca dëgjimore ka qenë në të gjitha rastet e monitoruara, publike.

Institucionet e vettingut kanë nevojë për mbështetje shtesë financiare. Kur këto institucione filluan nga puna, numri i personelit dhe shpërblimi i punës së anëtarëve të tyre u reduktuan. Sot, duke qenë se vetting po funksionon, është e qartë se kriteri më i rëndësishëm që këto institucione po kontrollojnë është pasuria. Numri i personelit të kualifikuar i punësuar pranë këtyre institucioneve mendojmë se nuk është i mjaftueshëm.

Deri në fund të muajit Qershor janë dhënë vendime vetëm për 3.37 % të të gjitha subjekteve që do ti nënshtrohen vettingut, ndërkohë që janë 800 të tilla. Për 57 subjektet e para që duhet ti nënshtrohen vettingut me prioritet janë dhënë vendime nga KPK në një hark kohor prej katër muajsh, vetëm për 31.5% të tyre. **Nëse seancat për subjektet prioritare do të vazhdojnë me këtë ritëm, do të duheshin 6-7 muaj për përfundimin e tyre** në KPK, duke kushtëzuar në këtë mënyrë ngritjen e organeve të qeverisjes së drejtësisë.

KPK ka disponuar me vendime për 27 subjekte të rivlerësimit në total, deri në fund të muajit Qershor 2018, ku në 12 raste vettingu është ndërprerë për shkak të dorëheqjes, në 9 raste është vendosur konfirmim në detyrë dhe në 6 raste shkarkim nga detyra.

Transparenca e zbatuar gjatë procesit të vettingut mendojmë se nuk duhet të cenohet dinjitetin njerëzor të personit që rivlerësohet. Çdo lloj paragjykimi ndaj subjektit të rivlerësimit, nominalisht apo në grup, do të ishte i dëmshëm dhe i pajustificueshëm.

Institucionet e rivlerësimit, ashtu sikurse çdo organ publik kanë detyrim të bëjnë kallëzim në prokurori, nëse gjatë procedimit administrativ zbulojnë një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht. Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të KPK-së dhe atyre të siguruara nga Organi i Prokurorisë deri më tani, rezulton se, ka pasur referim në prokurori vetëm për një subjekt, ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese të dorëhequr (B.I). Për këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur në dt. 03.04.2018 mos fillimin e hetimeve.

3. GJETJET KRYESORE

3.1 Konkluzione të përgjithshme


Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur ndryshe si vetting është një proces i rëndësishëm por gjithashtu edhe kompleks pasi është një hallkë e jashtëzakonshme dhe kalimtare e reformimit të sistemit të drejtësisë që do të realizohet vetëm një herë, ndaj paraqet edhe rëndësi historike.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka monitoruar me ekspertizë vendase dhe ndërkombëtare këtë proces². Në procesin e monitorimit janë angazhuar ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të Shoqatës së Prokurorëve Serbë dhe ekspertë vendas të së drejtës kushtetuese dhe administrative.

Për shkak të rëndësisë së këtij procesi, ky raport përfshin të dhëna të hershme në kohë të monitoruara nga KShH që nga hartimi dhe miratimi i paketës ligjore të vettingut (ndryshimet kushtetuese dhe ligji i vettingut) deri në periudhën që aktualisht janë duke u ndjekur seancat dëgjimore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht nga data e miratimit të Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar për gjyqtarët dhe prokurorët në R.Sh” deri në fund të muajit Qershor 2018. Monitorimi i KShH-së do të vijojë për periudhën Korrik 2018 – Qershor 2019 dhe raportet e monitorimit do të ndahen me institucionet e vettingut, publikun, median dhe aktorët e interesuar për këtë proces.

ÇFARË SYNON MONITORIMI I KSHH-SË?

Çfarë synon monitorimi i KShH-së?



² Me mbështetje të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros)

Nisma e KShH-së³ synon të nxisë transparencën dhe llogaridhënien e organeve të Vettingut, të monitorojë respektimin e të drejtave të subjekteve që i nënshtrohen vettingut si dhe përfshirjen dhe informimin e vazhdueshëm të qytetarëve, medias dhe shoqërisë civile në procesin e zbatimit të tij. KShH ka publikuar vazhdimisht gjetjet⁴ që kanë rezultuar nga monitorimi pro aktiv i procesit të zbatimit të reformës në drejtësi dhe në mënyrë të veçantë, të legjislacionit të vettingut.

KShH vlerëson të rëndësishëm angazhimin e ekspertizës vendase në monitorimin e procesit të vettingut. Raportet e publikuara të vëzhguesve vendas kontribuojnë në drejtim të rritjes së **transparencës** dhe **përgjegjshmërisë** së vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dy komponentë të rëndësishëm për rikthimin e besimit të shtetasve në organet e drejtësisë.

Paketa ligjore bazë e reformimit të sistemit të drejtësisë, përkatësisht amendamentet kushtetuese dhe shtatë ligjet e para organike u hartuan duke përfshirë dhe konsultuar një sërë aktorësh, ndër të tjerash edhe organizatat e shoqërisë civile. Kjo paketë ishte voluminoze por tepër e rëndësishme sa i takon nevojës për të reformuar sistemin e drejtësisë dhe adresimit të problematikave me të cilën përballëj ky sistem për një periudhë tranzitore gati 26 vjeçare. Në kushte dhe rrethana të zakonshme, kjo paketë ligjore do të kërkonte një periudhë më të gjatë kohore për tu hartuar dhe konsultuar me cilësi dhe profesionalizëm me të gjithë aktorët e interesuar. Megjithatë, kushtet dhe rrethanat në të cilat kjo paketë ligjore u hartua ishin të jashtëzakonshme për shkak të problematikave të vazhdueshme me të cilat po përballëj sistemi i drejtësisë dhe nivelit të korrupsionit të përhapur në të gjithë sektorët shtetërorë, ku tepër shqetësues ishte ai në sistemin e drejtësisë.

Ndryshimet kushtetuese për reformimin e sistemit të drejtësisë⁵ u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) më dt. 22.07.2016, ndërkohë që ligji i parë reformues i sistemit të drejtësisë që u miratua nga Kuvendi në datë 30.08.2016 ishte Ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë” (ligji i vettingut). Edhe pse kanë kaluar rreth 2 vite nga miratimi i kësaj pakete ligjore, ngritja dhe funksionimi i insti-

³ “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut” – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA)

⁴ <http://www.ahc.org.al/multimedia/deklarata/>


⁵ Ligji Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, dt. 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

tucioneve kushtetuese të vettingut u shoqërua me vonesa. Ndërkohë, një sërë institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë nuk janë ngritur dhe nuk kanë filluar ende nga funksionimi, sikurse janë Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj), Këshilli i Lartë të Prokurorisë (KLP), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED)⁶, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Institucionet e specializuara për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

3.2 Arsyet e vonesave në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë

ARSYET E VONESAVE NË NGRITJEN E INSTITUCIONEVE TË REJA TË DREJTËSISË

— Arsyet e vonesave në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë



Së pari, reformimi i kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë u realizua në një klimë relativisht të polarizuar politike, çka solli mosmiratimin në të njëjtën kohë të shtatë ligjeve të para organike të sistemit të drejtësisë⁷. Për këtë arsye, procesi i zbatimit u shoqërua me mospërputhje të afateve dhe parashikimeve të tjera tranzitore të parashikuara në këto ligje për funksionimin e institucioneve ekzistuese si dhe ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë veprimtaria e të cilave është e ndërlidhur dhe në disa raste e kushtëzuar me ngritjen apo funksionimin e këtij apo atij institucioni.

⁶ Anëtarët e këtij Këshilli nuk i janë nënshtruar ende procesit të vettingut.

⁷ Në datën 6 Tetor 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi këto ligje: Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”, Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në datën 03.11.2016, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”.

Së dyti, ushtrimi i së drejtës kushtetuese të ankimit në Gjykatën Kushtetuese⁸ ndaj Ligjit nr. 84/2016 të vettingut⁹ si dhe pezullimi i përkohshëm i zbatimit të këtij ligji nga Gjykata Kushtetuese, vlerësohet si një faktor që ka shkaktuar vonesa në ngritjen e Institucioneve kushtetuese të Vettingut¹⁰, si dhe ecurisë së zbatimit të tij të mëtejshëm. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vendosi të rrezojë kërkesën për antikushtetutshmërinë e këtij ligji me vendimin nr.2, dt.18.01.2017.

Së treti, vlerësohet se bojkoti i përkohshëm parlamentar ishte një tjetër faktor ndikues në vonesën për ngritjen e institucioneve kushtetuese të vettingut dhe më konkretisht për mosrespektimin e afateve ligjore të parashikuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit Nr. 84/2016 “Dëshmimi i kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me veprimtarinë e komisioneve parlamentare *ad hoc* për përzgjedhjen dhe verifikimin e kandidatëve për anëtarë të këtyre organeve.

Arsyet e vonesave në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë

Arsyet e vonesave në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë

Së katërti, Kuvendi miratoi në datën 17/06/2017, Vendimin nr. “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016”, megjithatë pati disa vonesa në drejtim të akomodimit të anëtarëve të këtyre institucioneve në godina me infrastrukturën e përshtatshme, miratimit të buxhetit të tyre dhe pajisjes me personel mbështetës.

Së pesti, vonesat e sipërpërmendura për zbatimin e ligjit të vettingut ndikuan në mënyrë zinxhir në përmbushjen e atyre funksioneve kushtetuese dhe ligjore të institucioneve të vettingut që kanë të bëjnë me ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të tjera të reja, të sistemit të drejtësisë dhe në mënyrë të veçantë të dy Këshillave, atij të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.¹¹ Në këtë drejtim, i referohemi konkretisht procesit të vettingut të kandidatëve për anëtarë gjyqtarë dhe prokurorë, përkatësisht në këto dy këshilla. Vettingu i këtyre kandidatëve është kërkesë thelbësore e legjislacionit të ri, para se ata të votohen nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

⁸ Nga 1/5 e deputetëve dhe Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë.

⁹ Vendim nr. 2 datë 18.01.2017, i Gjykatës Kushtetuese të RSh-së

¹⁰ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Komisionerët Publikë (KP) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA)

¹¹ Vonesa për ngritjen e këtyre dy Këshillave krijoi gjithashtu edhe vështirësi për gjetjen e kandidaturave të përshtatshme për anëtar jo gjyqtar dhe jo prokuror, në radhët e shoqërisë civile.

3.3 Ndikimi i vonesave në drejtim të aksesit në drejtësi të qytetarëve

Vonesat e sipërpërmendura kanë ndikuar në mosplotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, në gjykatat/prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm për shkak të dorëheqjeve të dhëna në kuadër të vettingut si dhe në emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm¹² me mandat të plotë.

Vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese janë tepër shqetësuese dhe kanë paralizuar krejtësisht veprimtarinë e këtij institucioni me funksione të rëndësishme kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimin përfundimtar të kushtetutës, dhe në mënyrë të veçantë për kërkesat për papajtueshmëri të ligjeve me Kushtetutën si dhe ankesat e individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese.

Këto vonesa mund të kenë sjellë pasoja ose mund të kenë dëmtuar efikasitetin e gjyqimit dhe drejtësinë e kërkuar nga qytetarët edhe në Gjykatën e Lartë. Vlen të përmendim se kjo e fundit aktualisht vijon të përballet me një mbingarkesë tepër të lartë për shkak edhe të dosjeve të mbartura nga vitet e kaluara. Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve të lartë, fluksi i dosjeve të rekursuara, stoku prej 23.900 dosjesh i krijuar ndër vite që presin në radhë për t'u gjykuar dhe mos funksionimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili përcakton numrin e gjyqtarëve në Gjykata e Lartë dhe i emëron ata në detyrë, vlerësohet se janë disa nga shkaqet e mungesës së efikasitetit të Gjykatës së Lartë¹³.

3.4 Procedurat parlamentare për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar në organet e vettingut

KShH ka monitoruar procedurat parlamentare të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar në institucionet kushtetuese të vettingut. Gjatë periudhës maj-qershor 2017, KShH monitoroi 4 seanca dëgjimore publike dhe procesin e përzgjedhjes të zhvilluar nga 3 komisionet e posaçme (ad hoc) parlamentare, të ngarkuar me përgjegjësi për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve. 20% nga 84 kandidatët në këto institucione që u dëgjuan nga Komisioni i parë ad hoc i verifikimit morën paraprakisht rekomandime negative nga ONM-ja, për çështje që lidhen


¹² Funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm ushtrohen në mënyrë tranzitore (të përkohshme) nga Prokurori i Përgjithshëm i zgjedhur nga Kuvendi i RSH në dt.18 Dhjetor 2017

¹³ <http://top-channel.tv/2018/04/25/kaos-dhe-pushime-ne-gjykatën-e-lartë/>

me konfliktin e interesit dhe të pasurive të pajustificuara të këtyre kandidatëve. Megjithatë, ky komision parlamentar pranoi se këta kandidatë plotësonin kriteret formalo – ligjore. Vëzhguesit e KShH-së vunë re se gjatë seancave dëgjimore me kandidatët për anëtarë në këto organe, disa prej tyre u vunë nën presion politik gjatë intervistës (seancës dëgjimore), e cila në fakt duhet të kishte si objektiv kryesor testimin e nivelit profesional të kandidatëve.

Seancat dëgjimore në dy Komisionet e tjera parlamentare *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve, në përgjithësi respektuan parimin e transparencës. Megjithatë u vërejtën problematika të tilla si, pyetjet e pakta të anëtarëve në drejtim të kandidatëve¹⁴, përzgjedhja në masë e kandidatëve që janë arsimuar dhe kanë punuar brenda vendit, ndërkohë që një numër relativisht i lartë kandidatësh jo të përzgjedhur ishin arsimuar ose kishin pasur përvoja të vlerësueshme në vendet perëndimore. Pengesë për këta të fundit ishin kriteret kushtetuese e ligjore për tu zgjedhur në pozicionet që kandidonin.

MONITORIMI I KOMISIONEVE AD HOC - VETTING



■ **Aspekte Pozitive**

■ **Aspekte Pozitive**

¹⁴ Në 12 raste nga 59 intervista (vetëm 20% të rasteve), anëtarët e Komisionit Parlamentar Ad hoc përzgjedhës adresuan pyetje në drejtim të kandidatëve

3.5 Aktet nënligjore të organeve të vettingut

KShH ka ofruar oponentë ligjore për akte nënligjore (rregulloret)¹⁵ të miratuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA). Sugjerimet dhe komentet e KShH-së janë përcjellë pasi këto akte janë miratuar, pasi rezultoi që të trija institucionet e vettingut nuk ju përgjigjën në kohë kërkesës tonë zyrtare për informacion, ku si shkak vlerësohet mungesa e personelit ndihmës dhe e zyrës së protokollit, disa muaj¹⁶ pas emërimit në detyrë të anëtarëve të këtyre institucioneve nga Kuvendi¹⁷. KShH vërejti se rregulloret ishin mjaft të detajuara dhe lejonin normimin edhe të çështjeve që nuk janë të domosdoshme ose të cilat tashmë janë të rregulluara në pjesë të tjera të legjislacionit që kanë një hierarki më të lartë. Në disa raste, rregulloret përmbanin dispozita të cilat konfliktin me legjislacionin me hierarki më të lartë. Ndërkohë që komunikimi ynë i parë zyrtar me institucionet e vettingut për konsultimin e rregulloreve është realizuar në muajin Shtator të vitit 2017, rezultoi që protokollit i këtyre institucioneve ka funksionuar disa muaj më pas. Kështu, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) ka regjistruar me nr. 119 Prot, dt. 22.02.2018, shkresën e ripërsëritur të KShH-se, nëpërmjet të cilës janë përcjellë opinionet e eksperteve për rregulloren “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”. KPA-ja, nëpërmjet shkresës nr. 119/1 Prot, dt. 23.02.2018, ka kthyer përgjigje KShH-se, duke i bere me dije se në momentin e rishikimit të rregullores do të merren në konsideratë opinionet dhe rekomandimet e dhëna nga ekspertet e KShH-se.¹⁸

3.6 Pagat, buxheti dhe personeli i organeve të vettingut

KPK, KPA dhe Komisionerët Publikë janë institucione të pavarura kushtetuese, të cilat sipas nenit C të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë.

¹⁵ Për Rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në KPK” si dhe për Rregulloren “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelimit”

¹⁶ Shkresa me nr. Prot 496, dt. 05.09.2017, drejtuar 3 Institucioneve të Rivlerësimit nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (kërkesë për informacion për draft rregulloret)

¹⁷ ?????????

¹⁸ Nga komunikimi me KPA-në, rezultoi se rregullorja “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese” e miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.07.2017 të mbledhjes së gjyqtarëve është ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 06.06.2018 të mbledhjes së gjyqtarëve. Për më shumë informacion referojuni linkut: <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Rregullore-p%C3%ABr-veprimtarin%C3%AB-e-KPA.pdf>

Propozimi për klasifikimin e pagave dhe strukturën organike¹⁹ u shoqërua me diskutime dhe debate të forta në seancat dëgjimore të Komisionit Parlamentar përgjegjës të Ligjeve²⁰, për shkak se niveli i pagave u konsiderua i lartë dhe struktura organike e personelit e fryrë, nga disa anëtarë të këtij Komisioni²¹. Në datën 29 Shtator 2017, Kuvendi miratoi me vendimet nr.92, 93 dhe 94, strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Komisionerëve Publikë²². Propozimi i institucioneve të vettingut për nivelin e pagave me një shtesë për vështirësi në masën 200% nuk u miratua, ndërkohë që u vendos për një organikë të shkurtuar të personelit në masën 40% në raport me propozimet fillestare të organeve të vettingut²³. Në datën 09 Tetor 2017, Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit Nr. 574, me propozimin e Ministrit të drejtësisë dhe Ministrit të financave dhe ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi se anëtarët e institucioneve të rivlerësimit do të përfitojnë një pagesë mujore shtesë në masën 50% mbi pagën bruto fillestare, për shkak të vështirësisë.

KShH nuk mund të vlerësojë nëse niveli i pagave të miratuara nga Kuvendi së bashku me shtesën për vështirësi të akorduar nga Këshilli i Ministrave, për anëtarët e institucioneve të vettingut është ose jo ai i duhuri. **Megjithatë për shkak të rëndësisë, natyrës dhe vështirësisë së lartë të punës së këtyre institucioneve, si dhe kontrollit rigoroz që këto institucione duhet të kryejnë në drejtim të pasurisë dhe figurës së subjekteve, paga e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit ka rëndësi të veçantë në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe efijencës së këtyre institucioneve.**

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për strukturën organizative dhe organikën e personelit të institucioneve të rivlerësimit. **I diskutueshëm është numri i personelit të miratuar në organikën e çdo institucioni, pasi institucionet janë përballur me një ngarkesë tepër të lartë që në muajt e parë të punës së tyre dhe vettingu i subjekteve të para që janë shortuar ka ecur me ritme relativisht të ngadalta.** Kjo mund të kërkojë rishikim të këtyre organikave në të ardhmen me mundësinë për të rritur numrin e personelit që ti përgjigjet ngarkesës reale të

¹⁹ Sipas nenit 19, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.84/2016 “1. Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta. 2. Institucionet e rivlerësimit propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre në komisionin që mbulon çështjet ligjore pranë Kuvendit, që e paraqet për miratim në Kuvend, si pjesë integrale të Buxhetit të Shtetit”.

²⁰ Seancë në Komisionin e Ligjeve në Kuvendin e RSh-së, dt. 19 dhe 25 Shtator 2017.

²¹ <http://www.oranews.tv/article/zbatimi-i-vettingut-prezantohen-ne-kuvend-strukturat-e-3-organeve>

²² Shih Fletoren Zyrtare nr. 174, dt. 03.10.2017.

²³ <http://www.gazetatema.net/2017/10/09/qeveria-korrekton-pjeserisht-nivelin-e-pagesave-per-komisioneret-e-vettingut/>

këtyre institucioneve. Rishikimi i strukturës dhe organikës së personelit, vlerësojmë se duhet të argumentohet dhe kërkohet me iniciativën e vetë institucioneve të vettingut, drejtuar Kuvendit të RSH. Nga konsultimi i draftit të këtij raporti me KPK-në, rezulton se ky organ i është drejtuar në dt.26.06.2018 Kuvendit me kërkesë për shtim personeli, duke parë ngarkesën e madhe të çështjeve. Sipas KPK-së, personeli i institucionit ka punuar me orare të zgjatura për të shmangur çdo vonesë në proces.

Vonesa janë konstatuar edhe për sa i përket rekrutimit të personelit në plotësim të organikës së institucioneve të rivlerësimit, ndërkohë që këto institucione vijojnë të kenë disa vakanca për pozicione të ndryshme në këtë organikë²⁴. Sipas njoftimeve zyrtare apo atyre në media²⁵, institucionet e rivlerësimit janë pajisur me një pjesë të personelit, fillimisht për pozicionet këshilltar ligjorë dhe ekonomikë, rreth shtatë muaj pas emërimit në detyrë të anëtarëve të vetë institucionet e vettingut. Kjo situatë ka ndikuar në ngadalësimin e shpejtësisë së nisjes dhe ecurisë së procesit të vettingut për shkak të rëndësisë dhe mbështetjes që ofron personeli i institucioneve të rivlerësimit.

3.7 Pengesat dhe vonesat në punën e organeve ndihmëse (ILDKPKI, DSIK, KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme)

Për shkak të rolit dhe të rëndësisë që kanë katër organet ndihmëse²⁶ në procesin e vettingut, KShH ka kërkuar të njihet me anë të kërkesave zyrtare për informacion, me veprimtarinë e tyre në këtë drejtim, vështirësitë në zbatimin e legjislacionit të vettingut si dhe të dhënat statistikore që ju kanë rezultuar këtyre organeve në drejtim të kontrollit të figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale të subjekteve të vettingut.

²⁴ Më dt. 29 Maj 2018, njoftim për rishpallje të vendit vakant për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të KPK-së: <http://kpk.al/2018/05/29/rishpallje-vendi-vakant-ne-pozicionin-sekretar-i-pergjithshem/>; Per KPA-ne vendet vakante janë publikuar ne <http://www.kpa.al/vende-vakante/>, Per Komisionerët Publike vende vakante janë publikuar ne <http://president.al/wp-content/uploads/2018/05/NJOFTIM-SHPALLJE-VEVDESH-VAKANTE-PRANE-KOMISIONERIT-PUBLIK.pdf>

²⁵ Për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ka rezultuar se shpallja e vendeve të lira për 14 këshilltarë ligjorë dhe 4 këshilltarë ekonomikë është bere ne dt.6 Tetor ne faqen e Presidencës (<http://www.arberianews.com/presidencia-shpall-vende-te-lira-pune-per-keshilltare-prane-kpk-se/>) ndërkohë qe procedurat e rekrutimit te tyre kane përfunduar ne dt. 3 Janar 2018 (shih <http://kpk.al/2018/01/03/njoftim-mbi-perfundimin-e-procedurave-te-rekrutimit-te-keshilltareve-ligjore-dhe-ekonomike/>); Per Komisionerët Publikë procedurat per shpalljen e 7 vende vakante për plotësimin e organikes kane filluar rreth datës 17 Tetor 2017 (<https://www.scan-tv.com/institucioni-komisionereve-publike-vende-vakante-per-6-keshilltare-dhe-1-kancelar/>); Per Kolegjin e Posaçëm te Apelimit procedurat per shpalljen e vendeve vakante per 7 këshilltarë ligjorë dhe 3 ekonomikë kane filluar ne dt.11 Tetor 2017 http://www.gjk.gov.al/web/PUBLIKIM_1512_1.php ndërkohë qe rezulton qe me vendimin nr.14, dt. 27 Dhjetor 2017 rezulton te jene shpallur fituesit (<http://www.oranews.tv/article/reforma-ne-drejttesi-konkurentja-keshilltare-ligjore-denoncon-parregullesite>)

²⁶ Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK);

Në disa raste, organet ndihmëse²⁷ kanë referuar se janë përballur me mungesa në burime njerëzore në raport me përgjegjësitë që u ka ngarkuar ligji. Në disa raste kemi vërejtur vonesa të pajustificuara në ngritjen e grupeve të punës të ngarkuara brenda këtyre institucioneve për të realizuar kompetencat ndihmëse, sikurse është rasti i Prokurorisë së Përgjithshme²⁸.

3.8 Transparenca e organeve ndihmëse dhe ballafaqimi i të dhënave të tyre

KShH ka reaguar publikisht për mungesën e transparencës së organeve ndihmëse ndaj organizatës tonë dhe publikut për mosvënien në dispozicion në mënyrë të plotë, të të dhënave statistikore që ju kanë rezultuar këtyre organeve në drejtim të kontrollit të figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale të subjekteve të vettingut.

Në dt.5 Shkurt 2018, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri) ka pranuar ankesat e KShH-së për cënimin e së drejtës së informimit dhe ka urdhëruar DSIK-në dhe ILDKPKI-në për ofrimin e informacionit të plotë statistikor në lidhje me pastërtinë e figurës si dhe ligjshmërinë e të ardhurave dhe pasurisë brenda 10-ditësh nga vendimi. Këto institucione nuk respektuan menjëherë vendimet e Komisionerit. Në këto kushte, KShH inicioi ose u bë pjesë e proceseve gjyqësore²⁹ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për moszbatimin apo ankimin e vendimeve të Komisionerit.³⁰ Fillimisht DSIK ankimoi vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, ndërkohë që për mosveprimin e ILDKPKI-së, ishte KShH që ju drejtua gjykatës administrative me kërkesë padi. Mosdhënia e informacionit nga këto organe, vlerësojmë se e cenoi përkohësisht të drejtën e informimit të publikut të garantuar në nenin 23 të Kushtetutës dhe

²⁷ Veçanërisht Inspektorati i KLD-së, që ka referuar 40% staf në mungesë.

²⁸ KPK dhe KPA janë konstituuar në muajin qershor 2017, ndërkohë që Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, përgjegjës për vlerësimin paraprak profesional të prokurorëve dhe ndihmësve ligjorë pranë saj është ngritur më dt. 17.10.2017, me Urdhrin nr. 801, të Prokurorit të Përgjithshëm

²⁹ Me objekte dhe palë të ndryshme ndërgjyqësore.

³⁰ DSIK ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ndaj Vendimit nr. 04, dt. 05.02.2018 të Komisionerit, ku KShH ka ndërhyrë si Person i Tretë në procesin administrativ. Për ILDKPKI, KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë për mos zbatim të Vendimit nr. 05, dt. 05.02.2018 të Komisionerit. Për Prokurorinë e Përgjithshme është ushtruar ankim ndaj Vendimit nr. 06, dt. 05.02.2018 të Komisionerit për refuzim të ankimit të KShH-së. Deri tani Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 1966, datë 22.05.2018 ka lënë në fuqi vendimin e Komisionerit në lidhje me rrëzimin e ankesës së KShH-së ndaj Prokurorisë së Përgjithshme. Me Vendimin nr. 2320, dt. 18.06.2018 Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë-padisë së DSIK për shfuqizimin e Vendimit nr. 04, dt. 05.02.2018 të Komisionerit, ndërsa me Vendimin nr. 2234, datë 11.06.2018 Gjykata ka rrëzuar Kërkesë-padinë e KShH-së për ekzekutimin e Vendimit nr. 05, dt. 05.02.2018 të Komisionerit në çështjen ndaj ILDKPKI-së. Ndaj Vendimit nr. 2234 KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ndërsa për Vendimin nr. 2320 nuk kemi dijeni për ndonjë ankim të mundshëm pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga palët në proces, DSIK apo Komisioneri.

nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Megjithatë, ndjekja e rrugëve ligjore nga KShH për të mundësuar transparencën e këtyre organeve, ndihmoi pozitivisht në këtë drejtim.

Në dt. 18.06.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrezimin e Kërkesë-padisë së DSIK duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionerit që i hapte rrugë transparencës për informacionin e kërkuar. Në vijim të këtij vendimi, është pozitiv fakti që DSIK ju drejtua KShH-së me shkresë për dhënien e informacionit, duke pranuar të zbatojë vendimin e Komisionerit dhe të Gjykatës Administrative. Sipas informacionit të DSIK-së, rreth 25% e subjekteve të kontrolluara prej tij kanë pasur probleme sa i takon figurës së tyre në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat janë shfaqur në formën e takimeve të papërshtatshme, shkëmbimit të korrespondencës elektronike të papërshtatshme apo në çdo lloj forme tjetër që sipas ligjit të vettingut konsiderohet e papërshtatshme. Ndërkohë që organi tjetër ndihmës, ILDKPI referoi publikisht në seancë dëgjimore para Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të njeriut se rreth 50% e subjekteve të kontrolluara nga ky organ kanë rezultuar me probleme sa i takon fshehjes së pasurisë, deklarimit të rremë apo konfliktit të interesit.


Të dhënat e organeve ndihmëse nuk janë të dhëna përfundimtare dhe as të detyrueshme për organet e vettingut, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila ka marrë në shqyrtim ligjin për vettingun kur subjektet e kanë kundërshtuar këtë ligj pranë këtij institucioni. Këto të dhëna, edhe pse janë shqetësuese në pamje të pare duhet ti nënshtrohen hetimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të kujdesshëm administrative të organeve të vettingut, në raport me të gjitha provat, faktet dhe dokumentet që janë gjatë këtij hetimi.

DSIK dhe ILDKPKI, sikurse është përmendur më sipër, kanë disponuar në raportet e tyre për secilin nga subjektet e kontrolluara, konkluzione ose vlerësime paraprake lidhur me dy komponentët për të cilat ato ndihmojnë. Ndërkohë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe Prokuroria e Përgjithshme referojnë se nuk disponojnë konkluzione lidhur me aftësitë profesionale në raportet e hollësishme dhe të arsyetuara që u vendosin në dispozicion komisioneve të vettingut për subjektet që ato kanë në kompetencë. Rrjedhimisht, KShH vëren se mënyra se si kanë vepruar organet ndihmëse në raport me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit pranë të cilit janë administruar këto raporte, nuk rezulton të jetë e unifikuar. Kjo mund të

vijë edhe për shkak të mënyrës se si janë formuluar dispozitat e ligjit të vettingut nr.84/2016.

Nga të dhënat paraprake që u arrit të merreshin nga DSIK, rezultoi se, një numër shumë i vogël gjyqtarësh ose prokurorësh nuk i janë përgjigjur me saktësi pyetjeve në formularët e vetë deklarimit ose kanë pasur mangësi në plotësimin e të dhënave për pastërtinë e figurës³¹. Gjithashtu, numri 794 i subjekteve të rivlerësimit që kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së nuk përputhet me numrin 801 të subjekteve që kanë dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës pranë DSIK-së. Shkak i mospërputhjes mund të jetë edhe dorëheqja e disa subjekteve të vettingut gjatë procesit të dorëzimit të formularëve të vetë deklarimit pranë këtyre organeve.

RAPORTI NDËRMJET NUMRIT TË SUBJEKTEVE TË RI-VLERËSIMIT QË KANË DORËZUAR DEKLARATËN PRANË DSIK DHE ILDKPKI



Nr. i subjekteve të ri-vlerësimit që kanë dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës pranë DSIK/801 subjekte

Nr. i subjekteve të ri-vlerësimit që kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë vetting pranë ILDKPKI / 794 subjekte

3.9 Transparenca e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

Sipas Aneksit B të Kushtetutës (paragrafët 1 dhe 3) roli i ONM-së është kufizuar shprehimisht në ushtrimin e kompetencave me natyrë monitoruese, pa asnjë rol vendim-marrës apo të lidhur me administrimin e procesit të vettingut. ONM mund të kontrollojë dosjet dhe informacionin në dispozicion si dhe të rekomandojë marrjen e provave shtesë apo ushtrimin e të drejtës së ankimit. ONM nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit por ka të drejtë të rekomandojë.


³¹ 3% e gjyqtarëve/prokurorëve lidhur me pastërtinë e figurës

Një çështje e diskutueshme ka të bëjë me transparencën e veprimtarisë së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, pasi publiku dhe media kufizohet vetëm në marrjen e informacionit gjatë seancës dëgjimore, kur vëzhgues të ONM-së kanë pyetje për subjektet e vettingut. Në vendimet e deritanishme të KPK-së, të arsyetuara, rezulton që sugjerimet e ONM-së për çështjen nuk reflektohen në vendim. Në këto vendime, vihet re që trupat gjyquese përmendin faktin nëse vëzhguesit e ONM-së kanë paraqitur ose jo sugjerim, por në disa prej tyre³², nuk reflektohet as ky fakt. Në ato raste kur përmendet dhënia e sugjerimeve për çështjen nga vëzhguesit e ONM-së, nuk specifikohet në vendim natyra apo konteksti i sugjerimeve, çka bën që roli dhe kontributi i ONM-së në këtë proces të mos jetë transparent për publikun. Theksojmë se sipas aneksit C të Kushtetutës, veprimtaria e organeve të vettingut duhet të udhëhiqet ndër të tjerash nga parimi i transparencës.

3.10 Shortimi i subjekteve të vettingut

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka realizuar deri më tani katër njoftime ku publikohen listat me subjektet që i janë nënshtruar shortit nga ky institucion për tu rivlerësuar. Në dt. 01.12.2017³³, është publikuar njoftimi i parë se kanë filluar procedurat e rivlerësimit për 57 subjektet e para të listës së përparësive, ndër të tjera për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Lartë, kandidatët për në KLGj, KLP, KED dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Një pjesë e këtyre kandidatëve do të rivlerësohen njëkohësisht për shkak të detyrës si gjyqtarë apo prokurorë dhe kandidimit në organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

SUBJEKTET PRIORITARE TË LISTËS SË SHORTUAR PËR VETTING



³² Vendimi nr.22, dt. 07.06.2018 për subjektin E.I.

³³ <http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

Në dt. 15 Janar 2018, KPK ka hedhur shortin dhe ka filluar procedurat e rivlerësimit për 36 subjekte të tjera të rivlerësimit, përkatësisht gjyqtarë që kryesojnë Gjykatat e Apelit dhe disa Gjykata të Shkallës së Parë, si dhe prokurorë që drejtojnë Prokuroritë e Apelit dhe që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë e Përgjithshme. Katër prej këtyre subjekteve janë njëkohësisht kandidatë për në KED.³⁴

Në dt.15.03.2018, KPK ka hedhur shortin dhe ka filluar procedurat e rivlerësimit për 36 subjekte të tjera të rivlerësimit, në radhët e kryetarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe drejtuesve të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore.³⁵

Në datën 15 maj 2018 është hedhur shorti dhe ka filluar procedura e rivlerësimit për 36 subjekte të tjera rivlerësimit, ku ndër emrat e parë në këtë listë janë renditur 7 kandidatë për Gjykatë Kushtetuese që aktualisht janë gjyqtarë në sistemin gjyqësor apo këshilltarë ose ish-këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese.³⁶ Gjashtë prej këtyre subjekteve i nënshtrohen procesit të vettingut *ex-officio* vetëm për shkak se janë gjyqtarë dhe këshilltarë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, është e paqartë përse në njoftimin e dt., 15 Maj, për shortimin e 7 prej subjekteve, është vendosur përbri emrit, në kllapa, kandidimi i tyre për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese nuk i nënshtrohen procesit të vettingut, por sipas ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" këta kandidatë, me kërkesë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen kontrollit të pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit si dhe kontrollit të integritetit nga Prokuroria e Përgjithshme. Nëse rezultati i procesit të vettingut të këtyre 7 subjekteve do të përdorej për efekt të kandidimit të tyre në Gjykatën Kushtetuese, kjo mund ti vendoste këta 7 kandidatë në pozita të pabarabarta me kandidatët e tjerë për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit/këshilltarëve apo ish – këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese.

3.11 Subjektet e dorëhequra

Duke filluar nga data 16 Shkurt 2018 deri në dt. 25 Qershor 2018, KPK vendosi të ndërpresë rivlerësimin kalimtar të 12 subjekteve, bazuar në aktet e tyre individuale të dorëheqjes³⁷. Tre prej këtyre subjekteve ishin pjesë e listës së subjekteve

³⁴ <http://kpk.al/2018/01/16/njoftim-per-mediat/>

³⁵ <http://kpk.al/2018/03/16/njoftim-4/>

³⁶ <http://kpk.al/2018/05/16/njoftim-15/>

³⁷ <http://kpk.al/vendime/>

të përparësisë të shortuar nga KPK. Nga këto 12 vendime rezulton se, 7 subjekte të rivlerësimit kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit, 4 subjekte të rivlerësimit kanë ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor dhe 1 atë të magjistratit (ish Prokurori i Përgjithshëm).

KATEGORIZIMI I SUBJEKTEVE TË DORËHEQURA

4		■	1 Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese
2		■	1 Gjyqtar në Gjykatën e Lartë
2		■	1 Gjyqtar në një nga gjykatat e apelit
1		■	1 Gjyqtar pranë njëres prej Gjykatave të Shkallës së Parë
1		■	2 Prokurorë në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë
1		■	4 Ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë
1		■	1 Ish Prokuror i Përgjithshëm (magjistrat)

Në faqen zyrtare të KPK-së rezulton se 4 vendime nuk kanë marrë ende formë të prerë. Nga të dhënat e publikuara në faqen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, rezulton se Komisioneri Publik ka ankimuar 2 vendime të KPK-së për ndërprerjen e procesit të vettingut për shkak të dorëheqjes së subjekteve të vettingut³⁸.

3.12 Afati i dorëheqjes

Nga 12 vendime të dorëheqjes, KSHH ka studiuar 11 vendimet e para të KPK-së për ndërprerjen e vettingut të subjekteve të dorëhequra. Nga studimi i 11 vendimeve të ndërprerjes, rezulton se 8 prej tyre janë paraqitur brenda afatit 3 mujor nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 84/2016. Në llogaritjen e këtij afati KPK ka marrë në konsideratë edhe pezullimin e zbatimit të Ligjit 84/2016 nga Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë. Si datë e përfundimit të afatit 3 mujor për paraqitjen e dorëheqjes është llogaritur data 31.03.2017. Vendimi i parë i KPK-së për ndërprerjen e vettingut daton në 8.02.2018. Për 8 nga kërkesat për dorëheqje brenda afatit 3 mujor që përkon me dt. 31.03.2017, bie në sy se vendimmarrja e KPK-së është përafërsisht 1 vit më vonë. Kjo vendimmarrje e vonuar mund të jetë kushtëzuar nga faktorë të tillë si miratimi i strukturës dhe organikës së personelit, rekrutimi i personelit apo dorëzimi i dokumentacionit të dorëheqjes nga Institucioni i Presidencës.

³⁸ <http://www.kpa.al/njoftime-per-shtyp/>. Për subjektin A. Ll, Kolegji i Apelimit ka marrë vendim, i shpallur publikisht në <http://www.kpa.al/shpallet-vendimi-pe%E2%80%8Br-subjektin-e-rivleresimit-z-adriatik-llalla/>

Nga analiza e tre vendimeve të ndërprerjes si rezultat i dorëheqjeve të subjekteve jashtë afatit 3 mujor, rezulton se KPK, bazuar në Nenin G të Aneksit të Kushtetutës si dhe në interpretimin e bërë në vendimin nr.78, dt.12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese³⁹, për dispozitat e Ligjit 84/2016 (nenin 56 të tij) ka pranuar mundësinë e dorëheqjes dhe të ndërprerjes së procesit të vettingut jashtë afatit 3 mujor.

3.13 Dorëheqja pranë organit të përcaktuar me ligj

Bazuar në vendimet e analizuara, në 9 nga 11 rastet, subjektet e rivlerësimit kanë paraqitur kërkesë për dorëheqje pranë Presidentit të Republikës dhe në 2 rastet e tjera dorëheqja është depozituar vetëm tek organi i emërtesës, pasi është paraqitur jashtë afatit 3 mujor të kërkuar nga ligji për depozitim pranë Presidentit të Republikës⁴⁰. Nga 9 subjektet që kanë paraqitur dorëheqjen pranë Presidentit të Republikës, tre prej tyre⁴¹ nuk e kanë depozituar atë pranë organit të emërtesës. Këtu përfshihen si subjekte që e kanë paraqitur brenda ashtu edhe jashtë afatit 3 mujor këtë kërkesë. Sipas të dhënave të disponueshme publikisht nga faqja zyrtare në internet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik ka ankimuar 2 vendime të KPK-së për ndërprerjen e procesit të vettingut për shkak të dorëheqjes së subjekteve të vettingut⁴².

Kështu, në Vendimin nr. 2 datë 16.02.2018 të KPK-së⁴³, rezulton se dorëheqja është depozituar jashtë afatit 3 mujor tek Presidenti i Republikës dhe jo tek organi i emërtesës. Nga vendimi i KPK nuk qartësohet nëse është kryer një hetim administrativ për të vërtetuar nëse Presidenti i Republikës ia ka dërguar *për kompetencë* kërkesën Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili në bazë të nenit 160 të Ligjit

³⁹ Në paragrafin 43 të këtij vendimi, GJK vlerëson se, sa i takon nenin 56, pika 1, të këtij ligji, kjo dispozitë është vlerësuar si kushtetuese për sa kohë që nuk i mohon subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dorëhequr, e drejtë që i garantohet atij nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

⁴⁰ Neni 56 i Ligjit 84/2016 e lidh paraqitjen e dorëheqjes pranë Presidentit të Republikës me afatin 3 mujor të kërkesës për dorëheqje. Kjo procedurë duhet interpretuar në mënyrë sistematike me parashikimet e neneve 64 dhe 65 të Ligjit Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", bazuar në të cilët dorëheqja depozitohet pranë Këshillit përkatës. Për shkak se këshillat përkatës nuk janë krijuar ende, bazuar në parashikimet e nenit 160 të këtij ligji, organet kompetente para të cilëve duhet të depozitohen kërkesat janë Këshillit i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

⁴¹ Vendimet Nr. 2 datë 16.02.2018; Nr. 4 datë 23.03.2018; Nr. 5 23.03.2018

⁴² <http://www.kpa.al/njoftime-per-shtyp/>

⁴³ Për subjektin Adriatik Llalla.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH” është organi kompetent që ushtron funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për periudhën kalimtare deri në krijimin e këtij këshilli. Lidhur me ankimin e ushtruar nga Komisioneri Publik për këtë vendim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur ashtu sikurse KPK ndërprerjen e vettingut, por duke saktësuar në dispozitivin e vendimit ndalimin e emërimit të subjektit (A. Ll), gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, inspektor i lartë i drejtësisë, Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë prej 15 vitesh⁴⁴.

3.14 Përmbajtja dhe forma e vendimit të ndërprerjes së vettingut (dorëheqjet)

Lidhur me përmbajtjen e vendimit, bazuar në parashikimet e nenit 57 të Ligjit nr. 84/2016 rezulton se vendimet përmbajnë elementët formalë të kërkuara nga ligji. Në të gjitha vendimet e arsyetuara nuk parashtrohet shkak i dorëheqjes, ndërkohë që nuk ka detyrim ligjor për justifikimin e dorëheqjes. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve, në rastet e vendimeve Nr. 2 datë 16.02.2018; Nr. 4 datë 23.03.2018; Nr. 5 23.03.2018, KPK nuk ka argumentuar nëse ka kryer një proces hetimi administrativ për të vërtetuar nëse dorëheqja është e rregullt dhe përse ka mjaftuar shkresa e Presidentit të Republikës dhe jo vendimi nga organi i emërtesës për përfundimin e mandatit ose statusit.

3.15 Ritmet me të cilat po zhvillohen seancat dëgjimore nga KPK

Në datën 21 Mars 2018, rreth katër muaj pas publikimit të listës për subjektet e para të shortuara për t’ju nënshtruar vettingut, KPK zhvilloi seancën e parë dëgjimore të vettingut që filloi në radhët e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ritmet me të cilat janë zhvilluar seancat dëgjimore me subjektet e rivlerësimit kalimtar, nga data 21 Mars kur është zhvilluar seanca e parë dëgjimore deri në datën 31 Maj konsiderohen të ngadalta në raport me numrin total të subjekteve që janë shortuar deri më tani nga KPK, përkatësisht 163 subjekte që presin ti nënshtrohen vettingut si dhe numrin anëtarëve të KPK-së⁴⁵, që siguron formimin e katër trupave gjyqësore njëherësh. Zhvillimi me ritme më të shpejta i këtij procesi, pa cënuar në

⁴⁴ Në momentin e monitorimit, vendimi i KPA-së nuk ishte arsyetuar ende ndaj nuk është bërë pjesë e analizës më të gjerë në këtë raport studimor. Vëzhguesit e KSHH-së i janë referuar dispozitivit të vendimit të publikuar në <http://www.kpa.al/shpallet-vendimi-pe%e2%80%8br-subjektin-e-rivleresimit-z-adriatik-llalla/>

⁴⁵ <http://kpk.al/rreth-nesh/komisioneret/>

asnjë rast cilësinë e vendimarrjes së institucioneve të rivlerësimit mund të ndihmojë në plotësimin e vendeve vakante në institucionet kyç të drejtësisë si dhe në institucionet e reja të drejtësisë si dhe zhbllokimin e ngërçeve që janë krijuar.

Konkretisht, deri në datën 30 Qershor 2018, KPK ka dhënë vendime për 18 subjektet prioritare që përbëjnë vetëm 11.04 % të 163 subjekteve që janë shortuar deri më tani nga ky organ. Për 9 prej këtyre subjekteve prioritare është vendosur konfirmim në detyrë, 6 prej tyre janë shkarkuar nga detyra ndërkohë që për tre prej tyre është vendosur ndërprerja e procesit për shkak të dorëheqjes. Mesatarja e gjykimit të këtyre subjekteve për periudhën 21 Mars – 31 Maj 2018, nga data e shortimit të tyre ka qenë mesatarisht 2 subjekte në muaj. Mesatarja e seancave të zhvilluara për subjektet prioritare në këtë periudhë, ka qenë dy seanca në javë për të njëjtin subjekt, ku seanca e parë ka qenë dëgjimore dhe e dyta për shpalljen e dispozitivit të vendimit. Në muajin Qershor vihet re një rritje e numrit të seancave dëgjimore, të cilat mesatarisht variojnë në 2 seanca dëgjimore në javë për dy subjekte të ndryshme. Veçanërisht, në dt.4-8 Qershor vihet re një numër i lartë seancash dëgjimore, përkatësisht 4 seanca për katër subjekte të ndryshme të vettingut. Në total, deri në datën 30 Qershor janë zhvilluar 30 seanca pranë KPK-së për 19 subjekte rivlerësimi. KShH ka monitoruar deri në fund të muajit Qershor 15 seanca dëgjimore.

Qëndrimi i KPK-së lidhur me këtë aspekt të monitoruar nga KShH është se vettingu i listës së përparësisë po zhvillohet me një intensitet të lartë dhe është drejt përfundimit. Thirrja në seancë dëgjimore e subjektit bëhet me vendim nga trupi gjykues përkatës. Trupat gjykuese punojnë në mënyrë të pavarur dhe caktimi i seancës dëgjimore, si hapi i fundit i procesit të ri-vlerësimit, bëhet brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm, rrjedhimisht nuk mund ti diktohet vullneti trupit gjykues. KShH respekton qëndrimin e KPK-së, megjithëse ndan një vlerësim të kundërt, bazuar në argumentet e dhëna më sipër. Gjithashtu, KShH vlerëson se pavarësisht nga mënyra e organizimit dhe e ndarjes së punës në trupa gjykuese, organet e vettingut, bazuar në nenin 4, pika 5 të ligjit nr.84/2016 ushtrojnë funksionet e tyre, ndër të tjerash, mbi bazën e parimit të barazisë përpara ligjit.

VENDIMET E KPK-SË PËR SUBJEKTET PRIORITARE

9 Vendime **konfirmimi në detyrë**

- 1. Dritan Prenci,**
Kandidat për KLP
- 2. Edmond Islamaj,**
Anëtar i Gj. Lartë
- 3. Anila Leka,**
Kandidate për KLP
- 4. Marçela Shehu,**
Kandidate për KLGJ
- 5. Manjola Xhaxho,**
Kandidate për KLGJ
- 6. Fatjona Memçaj,**
Kandidate për KED
- 7. Vitore Tusha,**
Anëtare e Gj. Kushtetuese
- 8. Bashkim Dedja,**
Kryetar Gj. Kushtetuese
- 9. Brikena Ukperaj,**
Kandidate KED, Gjyqtare,
Gj. Apelit. Vlorë

6 Vendime **për shkarkim nga detyra**

- 1. Fatmir Hoxha,**
Gjyqtar pranë Gj. Kushtetuese
- 2. Altina Xhoxha,**
Gjyqtare pranë Gj. Kushtetuese,
Anëtare për KED
- 3. Besa Nikëhasani**
Kandidate për KLP
- 4. Besim Trezhnjeva,**
Kandidat për KLGJ
- 5. Fatos Lulo,**
Anëtar i Gj. Kushtetuese
- 6. Gentian Trenova,**
Kandidat KED, Prokuror
në Pr. Apelit. Tiranë

3 Vendime **të ndërprerjes së vettingut**

- 1. Besnik Imeraj,**
Anëtar i Gj. Kushtetuese
- 2. Adriatik Llalla,**
Ish Prokuror i Përgjithshëm

Për 11 subjektet e tjera të rivlerësimit, 3 prej të cilëve i përkasin listës prioritare nuk është zhvilluar seancë dëgjimore dhe hetimi administrativ nuk ka filluar apo është ndërprerë për shkak të dorëheqjes së tyre (shpjeguar më sipër).

3.16 Transparenca e organeve të vettingut

Procesi, ndonëse i jashtëzakonshëm për Shqipërinë është zhvilluar në kushte normaliteti dhe transparence. Është pozitiv fakti se, KPK dhe KPA kanë publikuar në mënyrë të vazhdueshme në faqet zyrtare aktet (rregullatore) dhe vendimet, programin e transparencës si dhe njoftimet për shtyp të lidhura me procesin e vettingut. Gjithashtu, këto institucione kanë njoftuar paraprakisht datën e seancës për palët dhe për personat e tjerë të interesuar. Nga monitorimi i seancave dëgjimore pranë KPK-së, ka rezultuar se ky institucion ka pasur komunikim të vazhdueshëm me subjektet e ri-vlerësimit, për të zhvilluar të plotë procesin e hetimit administrativ dhe për t'u mundësuar subjekteve të njihen me të dhënat e dosjes dhe të paraqesin shpjegime, prova apo vlerësime.

Në tërësi, mund të themi se transparenca e të tri organeve të vettingut ka qenë në nivele të kënaqshme dhe është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme me anë të faqeve të tyre zyrtare, ku janë publikuar informacione për çështjet, seancat dëgjimore, ankimet, vendimet si dhe ka pasur njoftime të herëpashershme për shtypin dhe publikun lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre.

Një aspekt tjetër i monitoruar nga vëzhguesit e KShH-së ka të bëjë me transparençën e trupave gjyqesore gjatë seancës dëgjimore me subjektet e vettingut. Seanca dëgjimore, kur është publike, duhet të krijojë mundësinë për të gjithë të pranishmit (publikun) të njihen me faktet dhe rrethanat që kanë rëndësi sa i takon të tri kriterëve të vettingut. Në disa raste, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se gjatë seancave dëgjimore, relatorët e çështjeve janë ndalur në faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ vetëm për një nga komponentët e vettingut, kur ky i fundit ka rezultuar me probleme⁴⁶.

Në raste të tjera, vëzhguesit e KShH-së por dhe publiku i pranishëm nuk ka mundur të ketë qartësi qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur për aspekte të rëndësishme të procesit të vettingut gjatë seancës dëgjimore. Kështu, në seancën dëgjimore të dt.25 Qershor 2018 me subjektin V.S, ka rezultuar se relacioni i parë i ILDKPKI-së nuk përputhej me raportin e dytë të po këtij institucioni, i cili ishte kontaktuar sërish nga KPK gjatë hetimit administrativ. Ndërkohë që në relacionin e parë, ILDKPKI referonte se subjekti i vettingut nuk kishte pasur shkelje në drejtim të deklaramit të pasurisë dhe burimeve të krijimit të saj, në raportin e dytë ILDKPKI referonte se deklarimi i pasurisë nuk është bërë në përputhje me ligjin. Gjatë seancës dëgjimore nuk u shpjegua se përse KPK i kërkoi ILDKPKI-së përgatitjen e një relacioni të dytë dhe pse KPK e konsideroi raportin e dytë të ILDKPKI-së jo të bazuar në prova. Për të kontribuar në rritjen e besimit të publikut gjatë procesit, vlerësojmë se një transparençë më e mirë e trupave gjyqesore do të ndihmojnë në këtë drejtim. Gjithashtu, për transparençë ndaj publikut, gjatë seancës dëgjimore, relatori apo trupa gjyqesore duhet të relatojë/deklarojë rastet kur janë para detyrimit për të respektuar parimin e konfidencialitetit.

⁴⁶ Në seancën e dt.28.06.2018, kjo është evidentuar edhe nga avokati mbrojtës i subjektit A.L, i cili ka deklaruar se vlerësimi duhet të bëhet për të tre kriteret dhe jo vetëm për atë të pasurisë.

3.17 Bashkëpunimi dhe përfshirja e publikut në procesin e vettingut


Vlen të theksohet se transparencja e KPK-së por edhe jehona pozitive që ka pasur ky proces nga institucionet, shoqëria civile, përfaqësuesit e trupës diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare kanë mundësuar një pjesëmarrje aktive të qytetarëve për denoncimin e fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit (neni 53 i Ligjit).

KPK referon se deri në fund të muajit Maj 2018, ka pasur nga publiku rreth 736 denoncime në total⁴⁷. Përgjithësisht nga kjo shifër që vlerësohet relativisht e lartë, KPK ka vërejtur se natyra e denoncimeve ka të bëjë me aftësitë profesionale të gjyqtarëve/prokurorëve dhe bazohet në pritshmërinë e gabuar të qytetarëve mbi shqyrtimin e themelit të çështjeve, të referuara prej tyre. Pavarësisht kërkimeve të qytetarëve apo pretendimeve të tyre lidhur me themelin e çështjes, KSHH vlerëson se një komunikim pro-aktiv i organeve të vettingut me qytetarët si dhe një hetim i specializuar i çdo ankese, mund të evidentojë në raste të tilla, qoftë tërthorazi apo edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, edhe elementë të lidhur me aspektin e aftësive profesionale, pasurisë apo figurës për subjektet e vettingut ndaj të cilëve është paraqitur ankesa. **Nga komunikimi që kemi pasur me disa qytetarë të cilët rezultoi se kanë denoncuar pranë KPK-së, ata nuk kanë mundur të marrin informacion se çfarë është bërë me ankesën e tyre, nëse ka pasur ose jo një hetim administrativ dhe nëse KPK ka pasur nevojë për informacione apo dokumentacione shtesë lidhur me këto ankesa.**

Në kuadër të konsultimit të draftit të këtij raporti me KPK, ky organ referon se pritja e qytetarëve realizohet çdo ditë gjatë orarit 11:00 – 13:00. Takimi me qytetarët që i drejtohen këtij organi shoqërohet me sqarime përkatëse lidhur me problematikat e tyre dhe orientimin në plotësimin e formularëve të denoncimit të vënë në dispozicion nga KPK. Gjatë këtij procesi merret dokumentacioni provues, shoqëruar, mbi bazën e denoncimit të dorëzuar prej tyre. Denoncimi i qytetarit i dorëzohet relatorit të çështjes dhe bëhet pjesë e dosjes së subjektit të rivlerësimit për të cilin bëhet ky denoncim. Më pas, është trupi gjykues që vlerëson këtë denoncim të paraqitur si provë.

⁴⁷ Referuar Shkresës Nr. 4389/1 Prot., datë 07.06.2018 "Kthim përgjigje Tuajës nr. 498 Prot., dt. 28.05.2018" të KPK-së, drejtuar KSHH-së

BASHKËPUNIMI I QYTETARËVE ME ORGANET E VETTINGUT



■ Të dhënat për pjesëmarrjen e publikut në procesin e vettingut

Gjatë monitorimit të seancave dëgjimore, në disa raste relatori ka deklaruar se gjatë hetimit administrativ të subjektit të vettingut, ka pasur ankesa apo denoncime nga qytetarë të cilët kanë treguar fakte dhe rrethana që lidhen me komponentët mbi bazën e të cilave kryhet vettingu i subjekteve (gjyqtarëve/prokurorëve). Në të gjitha rastet identiteti i qytetarëve nuk është bërë publik, por janë paraqitur të dhëna vetëm sa i takon numrit të ankesave/deklarimeve dhe një përshkrim i shkurtër i gjetjeve/analizës së bërë në këto raste. Përgjithësisht, praktika e ndjekur deri tani nga relatorët e trupave gjykuese të KPK-së ka rezultuar përgjithësisht konstatuese lidhur me denoncimet e qytetarëve. Publikut të pranishëm në këto seanca nuk i është krijuar mundësi që të njihet me thelbin e këtyre ankesave.

Nga përmbajtja e vendimeve për subjektet që i janë nënshtruar vettingut deri më tani, nuk rezulton e qartë nëse janë pasqyruar ose jo të gjitha ankesat e qytetarëve ndaj subjekteve përkatës në këto vendime. Ka pasur raste kur KPK ka arritur në përfundimin se denoncimi i qytetarit për subjektin ka të bëjë me fakte të cilat zgjidhen në rrugë gjyqësore, mbi bazën e ushtrimit të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, dhe se ankesa nuk është objekt i punës së KPK-së⁴⁸. Megjithatë, nuk rezulton e qartë nëse KPK ka kryer një hetim administrativ lidhur

⁴⁸ Shih vendimin nr. 19, dt.14.05.2018 për subjektin M. Xh

me këtë denoncim të raportuar, nëse i është bërë e ditur qytetarit misioni i KPK-së apo nëse ky i fundit i ka qëndruar në mënyrë strikte pretendimeve apo objektit të denoncimit të bërë nga qytetari.

Me qëllim që besimi i publikut të fillojë të rikthehet që në fazat e para të zbatimit të vettingut, është e rëndësishme që qytetarët të informohen lidhur me hetimin administrativ të ankesave të tyre si dhe vendimmarrjen e KPK-së për subjektet ndaj të cilëve ata janë ankuar.

Është pozitiv fakti se për subjektet e rivlerësimit ka pasur transparencë lidhur me këto ankesa apo fakte të denoncuar nga publiku. Kjo pasi duke ju referuar vendimeve që janë arsyetuar deri më tani nga KPK, subjekti dhe mbrojtësi i tij janë njohur me rastet e denoncuar para zhvillimit të seancës së parë dëgjimore, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën (parashetrojnë kundër-argumente, prova të reja, etj.).

Sa i takon bashkëpunimit të qytetarëve me dy institucionet e tjera të vettingut, përkatësisht me Komisionerin Publik dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, rezulton se formulari i denoncimit të qytetarëve është publikuar në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë⁴⁹. Gjithashtu, KPA ka informuar KSHH-në se ka publikuar në faqen zyrtare të tij një model denoncimi, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga publiku si dhe administron regjistrin e denoncimeve të publikut në format elektronik dhe manual. Në këtë regjister regjistrohen të gjitha denoncimet e publikut të paraqitura në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimit postar, apo personalisht pranë KPA-së. Aktualisht denoncimet e paraqitura pranë KPA-se, janë përcjellë sipas rastit:

- a. *për trajtim pranë KPK-se, kur denoncimet i përkasnin subjekteve të rivlerësimit të cilët aktualisht janë në proces shqyrtimi, apo në pritje për tu rivlerësuar pranë këtij Institucioni.*
- b. *Dërguar pranë Komisionerit Publik dhe ONM-së, në rastet kur çështja e subjektit të rivlerësimit, për të cilin është bërë denoncimi ka përfunduar në KPK dhe është paraqitur në periudhën e afatit të ankimit prej 15 ditësh.*
- c. *Në dispozicion të trupës gjyquese pranë Kolegjit, në rastet kur çështja e subjektit të rivlerësimit, për të cilin janë bërë denoncimet është në proces shqyrtimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.*

⁴⁹ <http://ikp.al/index.php/denonco/>

Është pozitiv fakti se sipas KPA-së, në çdo rast denoncuesi është vënë në dijeni për trajtimin dhe shqyrtimin e denoncimeve të tyre, duke kthyer përgjigje zyrtarisht mbi ankesat / denoncimet e bëra. Megjithatë, mungon publikimi i të dhënave statistikore për denoncimet e bëra apo të shqyrtuara nga KPA dhe IKP, në faqen e tyre zyrtare.

Edhe pse qytetarët pretendojnë se sistemi i drejtësisë është i korruptuar, deri më tani, sipas të dhënave të siguruar nga institucionet me të cilat është realizuar korrespondencë zyrtare, nuk rezulton të ketë persona që duan të bashkëpunojnë me drejtësinë, në kuadër të procesit të vettingut . Neni 54 i ligjit 84/2016 që parashikon rregullim të detajuar për bashkëpunëtorët e drejtësisë, lehtësi dhe favorizime monetare për ta, praktikisht ka mbetur i pazbatuar deri më sot.

3.18 Respektimi i dinjitetit njerëzor të gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve)

Transparenca që ka mundësuar procesi i vettingut nuk duhet të cenojë dinjitetin njerëzor të subjekteve të vettingut. Çdo person, pavarësisht nga pozita zyrtare apo statusi publik, duhet të respektojë autoritetin përfundimtar të institucioneve të rivlerësimit dhe vendimmarrjen e tyre të formës së prerë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë subjekt i vettingut. KShH vlerëson se duhen shmangur format e reagimit që mund të perceptohen si ndërhyrje e qoftë e tërthortë në veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit apo në veprimtarinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që po i nënshtrohen vettingut. Pavarësia e pushtetit gjyqësor qëndron në themelet e organizimit dhe funksionimit të tij. Respektimi i kësaj pavarësie merr rëndësi akoma më të veçantë teksa po hidhen themelet e reja të sistemit të drejtësisë.

Çdo lloj paragjykimi ndaj subjektit të rivlerësimit, nominalisht apo në grup, është i dëmshëm dhe në raste të veçanta mund të cenojë dinjitetin e personit që i nënshtrohet këtij procesi. **Subjektet e vettingut, në disa raste kanë deklaruar se paragjykimet e shprehura publikisht kanë krijuar shqetësime të pan-evojshe në ushtrimin e profesionit dhe jetën e tyre familjare, edhe në radhët e gjyqtarëve apo prokurorëve që perceptohen si të pastër apo të aftë profesionalisht nga vetë komuniteti i tyre.**

3.19 Aksesi në infrastrukturë dhe dokumentacion

a) Aksesi në infrastrukturë

Salla ku zhvillohen seancat dëgjimore të KPK-së ndodhet në katin e dytë në ambientet e Pallatit të Kongreseve. Godina është në një vend tejet të njohur, shumë afër qendrës së kryeqytetit dhe lehtësisht e aksesueshme nga publiku dhe media. Salla e zhvillimit të seancës dëgjimore është mjaft e përshtatshme, me hapësirë të mjaftueshme, fonia ka qenë funksionale gjatë gjithë seancave të monitoruara dhe ndriçimi i përshtatshëm nga të gjitha këndet e sallës. Vendosja e karrigeve lejon akses pamor të publikut, pa cenuar konfidencialitetin në komunikimin mes subjektit dhe avokatit (në rastet kur kanë qenë të pranishëm).

b) Aksesi në dokumente/dosje/procedura gjatë komunikimit paraprak dhe seancës dëgjimore të KPK-së me subjektet e vettingut

Nga monitorimi i seancave të deritanishme, ka rezultuar që KPK ka zhvilluar komunikime paraprake me subjektet e ri-vlerësimit, kjo e konfirmuar nga vetë subjektet gjatë zhvillimit të seancës së parë, e në vijim. Gjatë kësaj fazë, subjekteve u është komunikuar dosja, gjetjet dhe dokumentacioni paraprak, si dhe ju është dhënë mundësia të japin shpjegime, komente, rreth dosjes/provave, e në vijim të sjellin edhe prova të tjera⁵⁰. Subjektet kanë deklaruar se ju është lënë afati 15 ditë për t'u njohur me dosjen nga hetimi administrativ i KPK-së dhe për të paraqitur prapësime.

Në të gjitha rastet e monitoruara, subjekteve u janë parashtruar të drejtat e tyre lidhur me hetimin administrativ të kryer nga KPK si dhe informacionin e marrë nga institucionet e tjera, për të paraqitur prova shtesë, komente, shpjegime dhe mendime rreth tyre, duke i lënë një **afat** i cili nga ana e KPK është gjykuar i përshtatshëm. KSHH konstatoi se afati ka qenë i ndryshëm në raste të ndryshme dhe ka variuar nga 5-10 ditë. Trupat gjykuese të KPK-së nuk kanë argumentuar kohëzgjatjen e ndryshme të afatit të paraqitjes së provave. Parashikimi i një afati më të gjerë për subjektet e rivlerësimit, të paktën 10 ditë vlerësojmë se i krijon subjekteve kushte dhe mundësi reale për paraqitjen e dokumenteve shtesë apo plotësuese, për një barazi të plotë të armëve dhe për një proces hetimi adminis-

⁵⁰ Bazuar në nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative 'E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime

trativ efektiv⁵¹. Në seancën gjyqësore të dt. 28 Qershor 2018, rezultoi se subjektit të rivlerësimit, në fund të hetimit administrativ të kryer nga KPK, i është njohur e drejta për të pasur akses në dosjen gjyqësore për një afat prej 5 ditësh. Ky afat është konsideruar i papërshtatshëm nga avokati mbrojtës, sipas të cilit, kërkohet një afat më i arsyeshëm për të sjellë prova të reja gjatë procesit (seancës dëgjimore), për shkak të rezultateve që kishte prodhuar hetimi administrativ i KPK-së.

3.20 Solemniteti, Paanshmëria dhe Etika e Trupave Gjyqësore të KPK-së

Seancat dëgjimore të monitoruara reflektuan një nivel të lartë solemniteti, i cili reflektohet që në aspektin logjistik, komunikimin e realizuar nëpërmjet koordinatorit të medias dhe publikut, në mënyrën e organizimit të sallës, të hyrjes së trupës gjyqësore, në korrektësinë e fillimit në kohën e përcaktuar të seancës, në parashtrimin e të drejtave të tij të subjektit të ri-vlerësimit, të njohjes dhe garantimit të së drejtës për t'u mbrojtur me një avokat, si dhe në kohëzgjatjen e arsyeshme të secilës prej seancave të monitoruara. Në të gjitha seancat e monitoruara, kanë qenë prezent përgjatë gjithë kohës së dëgjjesës anëtarët e trupës së KPK, si dhe përfaqësuesit e ONM, dhe kanë qëndruar në sallë deri në përfundimin e plotë të saj.

Gjatë seancave të monitoruara, është vërejtur një sjellje dhe komunikim brenda normave të etikës. Pavarësisht ngarkesës emocionale të vetë procesit, palët janë sjellë në mënyrë korrekte dhe nuk ka pasur fyerje, kërcënime apo komunikime me tone të larta. Subjekteve ju është bërë e njohur përbërja e trupës së KPK, ato janë njohur me përbërjen dhe deri në dt.30 Qershor është konstatuar vetëm një rast kur subjekti i rivlerësimit pati pretendime lidhur me konfliktin e interesit të njërit prej anëtarëve të trupës. Kjo kërkesë është paraqitur nga avokati i subjektit A.L në seancë dëgjimore dhe konflikti i interesit u pretendua për kryesuesen e trupës gjyqësore. Kërkesa nuk u pranua nga KPK referuar nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile dhe u quajt e vonuar.

⁵¹ Ligji për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare (N. 15) i jep afatin 10 ditë institucioneve për të lëshuar dokumentet e kërkuara (afat ky që në shumë raste nuk respektohet dhe tej zgjatet).

3.21 Publiciteti i seancave të zhvilluara nga KPK dhe KPA

KShH vlerëson respektimin e parimit të publicitetit në seancat e deritanishme dëgjimore të zhvilluara nga KPK dhe KPA, si një kërkesë thelbësore e së drejtës për një proces të rregullt. Qysh në fillim të procesit, para se të fillonin seancat dëgjimore të vettingut të subjekteve prioritare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeroi që salla ku do të zhvilloheshin seancat të ishin të përshtatshme për të realizuar në praktikë parimin e publicitetit. Ky sugjerim u mor parasysh.

Në të gjitha rastet e monitoruara, publiku dhe gazetarët janë lejuar të qëndrojnë në sallë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të saj. Në asnjë rast nuk është konstatuar që atyre tu kërkohej të largoheshin nga salla.

Me vendimin nr. 18, dt.13.03.2018, KPK ka miratuar Rregulloren (Guidën) për Mediat gjatë procesit të zhvillimit të seancave dëgjimore me subjektet e ri-vlerësimit. Në nenin 3 rregullorja parashikon se '(3.1) *Seancat dëgjimore të KPK-së janë publike dhe mund të ndiqen nga gazetarët*'. Rregullorja i njeht një diskrecion të gjerë trupës së KPK për të vendosur lidhur me sjelljen e gazetarëve dhe mediave në sallën e seancave dëgjimore si dhe në rastet kur mediat/gazetarët/publiku mund të lejohen të regjistrojnë/filmojnë, apo kohën kur mund të komunikojnë me mesazhe. Neni 3.9 i rregullave parashikon se '*Nëse u jepet leje nga ana e KPK-së dhe kur t'u jepet kjo leje, gazetarëve u lejohet të bëjnë regjistrime (pamore) të hyrjes zyrtare të trupës në sallën e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe në çeljen e seancës dëgjimore nga ana e kryesuesit të trupës gjyquese. Më pas fiken kamerat dhe mikrofonat dhe këto mjete hiqen nga salla e zhvillimit të seancës.*' Pak a shumë, i njëjti rregullim parashikohet edhe në Rregulloren e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit "**Për marrëdhëniet me mediat**", miratuar me vendimin nr. 11/1, datë 13.04.2018. Në nenin 3, pika 9 të kësaj Rregulloreje parashikohet se "*Pasi të kenë marrë leje nga Kolegji, mediat lejohen të bëjnë regjistrime (vizuale) të hyrjes në sallë të trupit gjyques dhe të çeljes së seancës nga kryesuesi i trupit gjyques. Më pas, kamerat dhe mikrofonat fiken dhe nxirren jashtë sallës ku zhvillohet seanca gjyqësore*"⁵².

Kufizimi i vendosur ndaj mediave dhe gazetarëve për të regjistruar të gjithë seancën dhe për të vendosur vetë më pas se cilat pjesë mund të paraqesin interes për publikun janë të diskutueshme në drejtim të respe-

⁵² <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/06/Rregullore-p%C3%ABr-mar%C3%ABdh%C3%ABniet-me-mediat.pdf>

ktimit të kërkesave të lirisë së shprehjes, sa kohë kufizime të tilla nuk janë të parashikuara shprehimisht në ligj, por rregullohen vetëm me akt nënligjor të KPK-së⁵³. Kodi i Procedurave Administrative dhe Ligji nr.84/2016 nuk parashikon kufizime për regjistrimin audioviziv të seancës dëgjimore nga media por ky i fundit (nr.84/2016) referon në nenin 20 të Ligjit për Gjykatat Administrative, i cili parashikon kufizime të parashikuara shprehimisht për zhvillimin e seancave me dyer të mbyllura. Nëse i referohemi Kodit të Procedurës Civile, në nenin 26 të tij, kufizimi për median vendoset ***rast pas rasti***, kur gjykata çmon se nuk është në dobi të gjykimit. Në çdo rast, sipas kësaj dispozite, vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht. Në të gjitha seancat dëgjimore të vettingut të monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së nuk ka pasur seanca të zhvilluara me dyer të mbyllura, megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, pas çeljes së seancës, medias i është kërkuar të mos regjistrojë/filmojë. Do të vlerësohej e dobishme nëse KPK dhe KPA do të diskutonin lidhur me nivelin e publicitetit të seancave të vetting-ut, dhe nëse e çmojnë të vlefshme, të shkojnë drejt një qasje sa më transparente dhe në respektim të lirisë së shprehjes, në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në..

Lidhur me këtë konstatim, dy prej organeve të vettingut, KPK dhe KPA kanë shprehur qëndrimet e tyre, të cilat nuk përputhen plotësisht sa i takon zbatueshmërisë apo interpretimit të parashikimeve pothuajse të njëjta të bëra në këto rregullore. Konkretisht:

KPK vlerëson se rregullorja për median është hartuar në bazë të nenit 20 të ligjit për gjykatat administrative⁵⁴, duke marrë parasysh praktikat më të mira pas konsultimeve me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit. Seancat dëgjimore të Komisionit janë publike dhe mund të ndiqen edhe nga gazetarët. Komisioni u mundëson mjedise dhe i ndihmon gazetarët të kryejnë misionin e tyre. Gazetarëve u lejohet të dërgojnë mesazhe në format teksti, duke raportuar mbi seancat në kohë reale. Në këtë mënyrë Komisioni ka për qëllim të ofrojë transparencë në proces, duke ruajtur njëkohësisht privatësinë e subjektit të rivlerësimit. Pra, në këtë rregullore, Komisioni është kujdesur edhe për të drejtat e subjekteve të rivlerësimit.

⁵³ E drejta e shprehjes së lirë është përcaktuar në nenin 22 të Kushtetutës dhe në nenin 10 të KEDNJ-së, ndërsa kufizimet e të drejtave të parashikuara në Kushtetutë përcaktohen në nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së.

⁵⁴ Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Ndërkohë, KPA vlerëson se në referim të rregullores së saj për marrëdhëniet me median, konkretisht në nenin 3, pika 1 parashikohet shprehimisht se “Seancat gjyqësore pranë Kolegjit janë të hapura për mediat dhe në këtë këndvështrim, mediat lejohen të bëjnë regjistrime audio-vizuale gjatë hapjes së seancës dhe vijimësisë së saj. Është e evidente se në të gjitha seancat e zhvilluara deri tani pranë KPA-së, mediat janë lejuar të bëjnë regjistrime audio-vizuale deri në përfundim të seancës gjyqësore. Lidhur me nenin 3, pika 9 të rregullores (cituar më sipër), KPA vlerëson se sipas këtij parashikimi, në rastet kur kryesuesi e konsideron të arsyeshme që kamerat të dalin jashtë për të mos cenuar mbarëvajtjen e seancës, gazetarët vijnë të ndjekin të gjithë seancën.

KShH respekton qëndrimin e KPK-së dhe KPA-së, megjithëse ndan një vlerësim të kundërt, bazuar në argumentet e dhëna më sipër. Bashkëpunimi i të dyja institucioneve të vettingut me median ka qenë pozitiv, çka e ka bërë transparent në sytë e medias dhe të publikut, procesin e deritanishëm të vettingut në këto dy instanca. Megjithatë, çështja e ngritur nga KShH në këtë pjesë të raportit ka të bëjë me mënyrën e formulimit të rregullores së të dy institucioneve për marrëdhëniet me median, ku kufizimet e vendosura tejkalojnë ato të parashikuara në Ligjin për Gjykatat Administrative, në Kodin e Procedurës Civile si dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3.22 E drejta për t'u mbrojtur (efektiviteti) dhe për tu dëgjuar (kontradiktoriteti)

Në të gjitha seancat e monitoruara nga KSHH, trupa gjyqësore e KPK-së ka pranuar mbrojtjen e subjekteve të ri-vlerësimit personalisht apo nëpërmjet avokatëve të zgjedhur prej tyre. Në asnjë rast kjo e drejtë nuk është mohuar.

Prezenca e avokatit do të thotë që ai mund të paraqesë të gjitha provat dhe prapësimet, si në rastin kur është prezent subjekti i ri-vlerësimit, edhe në rastin kur ai nuk paraqitet personalisht në seancën dëgjimore. Pavarësisht kësaj, në seancën dëgjimore të datës 21.03.2018, trupi gjykues u shpreh se nuk mund të parashtronte pyetje (as ai e as vëzhguesit e ONM-së) për subjektin e ri-vlerësimit, pavarësisht nga prezenca e avokatit të tij në këtë seancë, pasi subjekti nuk ishte personalisht i pranishëm. Në vlerësimin tonë, bazuar në nenin 55, pika 3 e Ligjit 84/2016 si dhe në parimet e procesit të rregullt, trupit gjykues i njihet e drejta që të parashtrojë pyetje edhe nëse subjekti i rivlerësimit nuk është prezent fizikisht por përfaqësohet përmes avokatit, i cili rezervon gjithmonë të drejtën që të mos u përgjigjet pyetjeve.

Gjatë monitorimit, është konstatuar në përgjithësi se KPK, ju ka njohur të drejtën palëve për të paraqitur prova të reja ose prova shtesë, si dhe parashtrime, komente, etj. Në të gjitha rastet e monitoruara, palët kanë paraqitur provat dhe pretendimet e tyre, dhe përgjithësisht ato janë pranuar nga KPK për t'u shqyrtuar në vendimarrjen e tij.

Në një nga seancat dëgjimore⁵⁵, avokati mbrojtës i subjektit kërkoi paraqitjen e provave të reja me argumentin se rezultatet e KPK-së në përfundim të hetimit administrativ kishin diktuar nevojën për të paraqitur prova të reja, dhe se këto prova nuk mund të paraqiteshin gjatë afatit të lënë në dispozicion nga KPK, i cili u vlerësua si jo i arsyeshëm. Kërkesa nuk u pranua nga trupi gjykues, me arsyetimin se gjatë hetimit administrativ paraprak, subjekti i rivlerësimit ishte njohur me çdo provë që kishte rezultuar nga ky hetim.

Në një rast tjetër⁵⁶, u konstatua se provat e reja të paraqitura nga subjekti në seancë konfliktin me provat e paraqitura nga trupa gjyqësore e KPK-së, ndaj avokati mbrojtës kërkoi thirrjen e një eksperti të pavarur për të përcaktuar vërtetësinë e provave që konfliktin. KPK vendosi të mos pranojë këtë kërkesë, me argumentimin se *'KPK disponon një provë (raportin e auditimit privat si edhe analiza financiare të dhëna nga autoritetet zyrtare) ndaj akti i ekspertimit përbën një provë të panevojshme'*. Refuzimi i kësaj kërkesë është i diskutueshëm dhe mund të cenojë parimet e procesit të rregullt ligjor.⁵⁷ Ligji i vettingut i jep mundësinë dhe të drejtën KPK-së të thërrasë një ekspert dhe akti i ekspertimit mund të merret në vlerën e provës (neni 49/1, gërma "b", Neni 49/2).

3.23 Monitorimi i Vendimeve të KPK (pikëpamja logjistike)

Nga monitorimi i vendimeve të shpallura nga KPK, rezulton se ato gjenden të plota në faqen zyrtare të internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kpk.al, seksioni Vendime, por ka vështirësi aksesimi i plotë i listës së Vendimeve, pasi duhet të kalohet në opsionin **'shkarko më tepër'**, dhe në këtë rast, rikthimi kryhet në po të njëjtën faqe kryesore.

⁵⁵ Seanca e dt. 28.06.2018, me subjektin A.L

⁵⁶ Gjatë seancës dëgjimore të datës 11.04.2018

⁵⁷ Neni 49/6 i ligjit 84/2016 - 'Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit; c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarrtshëm; ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjyqimit; d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit'.

Në këtë kontekst, për një akses sa më të lehtë në gjetjen dhe leximin e vendimeve të KPK, do të sugjerohet që lista e vendimeve të KPK të shfaqet e plotë në një faqe të vetme të internetit që mundëson përdorim sa më praktik të saj nga të gjithë të interesuarit, duke vendosur në këtë rubrikë numrin e vendimit, datën e publikimit të vendimit të arsyetuar në këtë faqe, identitetin e subjektit, si dhe funksionin që mbante para procesit të ri-vlerësimit, bazuar kjo edhe në faktin se në vijim do të ketë shumë më tepër vendime (modeli i Listës së Vendimeve në faqen e Gjykatës Kushtetuese).

Nga monitorimi i vendimeve të arsyetuara, në faqen e KPK, rezultojnë se vetëm një vendim ka mendim pakice – konkretisht Vendimi 18, datë 08.05.2018.

3.24 Standardet dhe qartësia e arsytimit të Vendimeve nga KPK

Nga monitorimi i Vendimeve të arsyetuara që janë publikuar në faqen zyrtare të KPK, rezultojnë se vendimet e konfirmimit në detyrë dhe të shkarkimit janë shumë të gjata dhe kanë përsëritje nga njëra pjesë tek tjetra.

Grupet gjyqësore kanë ndjekur standarde të ndryshme në mënyrën se si është strukturuar apo arsyetuar vendimi. Neni 57 i ligjit nr.84/2016 parashikon se relatori i çështjes arsyeton me shkrim vendimin e Komisionit, i cili përmban tri pjesë kryesore, hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe urdhëruese. Neni 57 përcakton se pjesa përshkuese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjyqësor; b) provat dhe arsyetimi mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.

Nga vendimet e studiuara deri më tani, vihet re se struktura e tyre nuk ndjek në të njëjtën mënyrë elementët e kërkuar sipas nenit 57 të ligjit nr.84/2016. Në përgjithësi pjesa përshkuese-arsyetuese e këtyre vendimeve nuk strukturohet në mënyrë të qartë sipas 4 aspekteve që duhet të përfshihen në të si dhe nuk është formuluar në mënyrë koncize apo edhe të kuptueshme. Gjatësia e një vendimi nuk është detyruesisht element përcaktues në vlerësimin nëse vendimi është arsyetuar ose jo shumë mirë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Duke pasur në konsideratë faktin se këto janë rastet e para të jurisprudencës së vettingut, e cila ende nuk është konsoliduar, si dhe faktin që një pjesë e anëtarëve të KPK-së nuk kanë përvoja të mëparshme në sistemin gjyqësor, vlerësojmë se do të ishte e rekomandueshme pjesëmarrja e tyre në trajnime që mundësojnë rritjen e kapaciteteve për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve. Mënyra se si arsyetohen vendimet dhe unifikimi i strukturimit, elementët e qartësisë, kuptueshmërisë dhe të qënurit konciz, vlerësojmë se janë çështje që duhet të jenë objekt i vazhdueshëm i diskutimeve në mbledhjet e anëtarëve të KPK-së.

Një pjesë e madhe e vendimeve janë bazuar kryesisht në analizën e vlerësimit të pasurisë së subjekteve të vettingut. Në pjesën arsyetuese të këtyre vendimeve është pasqyruar në mënyrë të detajuar hetimi administrativ që është kryer për subjektin e ri-vlerësimit, duke u fokusuar në vërtetësinë e deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të remë apo konfliktit të interesit.

Megjithatë, në drejtim të analizës së bërë në këto vendime për kriterin e pasurisë, është vërejtur paqartësi në disa prej veprimeve administrative të kryera nga KPK, çka në mënyrë të tërthortë ndikon në transparencën e vettingut karshi publikut. Kështu, në vendimin nr.19, dt. 14.05.2018, për subjektin M.Xh, nuk është e qartë pse KPK ka kërkuar rishikimin e aktit përfundimtar të kontrollit të deklaratës së pasurisë dhe të raportit të DSIK për subjektin. Për raportin e DSIK, mungesa e informacionit mund të lidhet me faktin se kemi të bëjmë me deklasifikim të informacionit, m.gj.th, mund të ishte bërë një analizë më e gjerë e këtij aspekti, për të pasur një përfundim të arsyetuar. Në një vendim tjetër (nr.17, dt.04.06.2018), KPK i kërkon ILDKPKI-së opinion ligjor, por nuk sqarohet apo qartësohet në vendim se për çfarë çështjesh është kërkuar ky opinion.

Në vendimin Nr. 14, datë 13.04.2018, KPK arsyeton se '... me vendimin nr. 4, datë 11.04.2018, trupa gjyqësore refuzoi kërkesën e subjektit për caktim ekspertësh' por nuk arsyeton në mënyrë të përmbledhur ku është bazuar kjo vendimmarrje, duke krijuar paqartësi tek lexuesi mbi bazueshmërinë e këtij vendimi. Mungesa e arsyetimit të këtij vendimi është vërejtur edhe gjatë komunikimit të tij tek subjekti, në seancën dëgjimore të vëzhguar nga monitoruesit e KShH-së.

Në një rast tjetër, Vendimi i KPK nr. 16, datë 03.05.2018 përmban terminologji të pa-përshtatshme pasi shkruhet se *'Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit **duken** bindëse dhe të mjaftueshme'* (fq. 7 e Vendimit), por nuk është e qartë për lexuesin se cilat janë provat konkrete mbi të cilat është arritur ky përfundim.

3.25 Vendimmarrja për një kriter a presupozon që të mos përfundojë vettingu për dy kriteret e tjera?

Në rastin e vendimeve të shkarkimeve, është vërejtur në disa prej tyre se KPK ka vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin vetëm mbi kriterin e pasurisë, duke mos përfunduar dhe duke mos marrë në konsideratë hetimet mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale⁵⁸. Në këto vendime, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ me pasurinë, trupat gjykuese kanë vlerësuar se kriteri i pasurisë është i mjaftueshëm për procesin vendimmarrës lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve përkatës.

Kushtetuta e RSH dhe ligji nr.84/2016 parashikon që procesi i vettingut kërkon kontroll të të tri komponentët që qëndrojnë në themel të tij, ndaj procesi nuk do të ishte i plotë dhe as transparent për publikun nëse subjektet nuk i nënshtrohen të trija filtrave të kontrollit

Në një nga vendimet e analizuara në këtë paragraf rezulton që për subjektin ka pasur 11 denoncime nga publiku, por pavarësisht kësaj, KPK nuk e ka përfunduar hetimin administrativ për aftësinë profesionale por ka hetuar vetëm kriterin e pasurisë. Mosrealizimi i plotë i vettingut për këto subjekte dhe ndryshimi i vendimmarrjes si rezultat i ushtrimit të së drejtës së ankimit në këto raste, mund të sjellë vonesa dhe zvarritje të procesit. Gjithashtu, kjo praktikë e KPK-së nuk është e qartë dhe konsekuente, pasi në raste të tjera, KPK ka marrë në analizë të tri kriteret.

Çfarë do të ndodhë në këto raste, nëse subjekti i shkarkuar për një kriter dhe për të cilin hetimi administrativ për dy kriteret e tjera nuk ka përfunduar, ushtron të drejtën e ankimit pranë KPA-së dhe nëse kjo e fundit vendos të ndryshojë vendimin apo të prishë vendimin e KPK-së? Si mund të përfundojë procesi për këto subjekte, në kushtet kur hetimi administrativ për dy komponentët e tjerë nuk është përfunduar nga KPK? Sipas nenit 66, pika 1 të ligjit nr.84/2016, KPA

⁵⁸ Shih vendimet nr. 12, dt. 23.03.2018 dhe nr. 14, dt. 13.04.2018, nr. 15, datë 20.04.2018.

në përfundim të procesit mund të disponojë me një nga këto vendime, së pari të lërë në fuqi vendimin e KPK-së, së dyti mund ta ndryshojë vendimin e KPK-së dhe së treti, mund të prishë vendimin e KPK-së. Pra në ndryshim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, KPA nuk mund të prishë vendimin plotësisht apo pjesërisht dhe ta dërgojë çështjen për rigjykim pranë KPK-së. E thënë ndryshe, në rast se KPA ka një vlerësim të ndryshëm sa i takon kriterit mbi të cilin subjekti është shkarkuar nga KPK, atëherë, KPA merr atributet e organit të instancës së parë të vettingut dhe duhet të përfundojë hetimin administrativ për dy kriteret e tjera të vettingut.

Lidhur me këtë çështje, KPK ka paraqitur observacionet e tij, duke evidentuar se realizimi i procesit të rivlerësimit është i përcaktuar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017 dhe nr. 78/2017, aneksi kushtetues dhe ligji nr.84/2016. Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurës, bazuar në neni 4 të ligjit nr.84/2016.

KShH respekton qëndrimin e KPK-së lidhur me këtë çështje, edhe pse vërejmë se neni 4 i ligjit nr.84/2016 i interpretuar në mënyrë sistematike me dispozitat e tjera të ligjit, sërish është i paqartë dhe mund të lexohet ndryshe nga sa po zbatohet deri më tani në jurisprudencën e KPK-së. Megjithatë, vlerësojmë se mund të jetë jurisprudenca e KPA-së për rastet e analizuara në këtë pjesë të raportit, apo raste të tjera analoge me to, e cila do qartësojë disa nga pyetjet e ngritura në këtë pjesë të raportit. Sipas nenit 66, pika 2 të ligjit nr.84/2016, Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

3.26 Standardi i analizës së kriterit të pasurisë në vendimet e KPK-së

Një çështje që nuk rezulton krejtësisht e qartë në vendimet e deritanishme të KPK-së të shkarkimit ka të bëjë me përkufizimin e fshehjes së pasurisë dhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, kur institucionet e vettingut konstatojnë fshehje të pasurisë. Kështu, në vendimin e KPK nr. 14, datë 13.04.2018,

për subjektin B.T, ky i trupa gjykuese vlerësoi se subjekti ka fshehur në deklaratën e pasurisë, të ardhurat neto nga paga e vajzës së tij, e punësuar në një institucion publik, në vlerën 148.226 Lekë. Në këtë vendim evidentohet se subjekti dhe personat e lidhur kanë detyrimin të deklarojnë të ardhurat neto si burime të ligjshme dhe gjendjet e llogarive bankare deri në periudhën e deklarimit, pavarësisht nëse këto të ardhura janë krijuar ose jo nga burime të ligjshme. Lidhur me këtë çështje është e vështirë të arrish në një konkluzion, duke mos qenë në dijeni të hetimit administrativ. Mos deklarimi nga subjekti i kësaj shume mund të jetë edhe një pasaktësi në deklarim. Është e vështirë ta kualifikosh këtë shumë si fshehje jo vetëm për shkak të vlerës jo të lartë, por sepse është llogari page, e për më tepër punëdhënësi i vajzës së subjektit është organ shtetëror. Fshehja kërkon të ketë elementin subjektiv, pra qëllimin për të mos deklaruar të ardhurat dhe në këtë rast qëllimi për të fshehur këto të ardhura nuk bën sens nëse kemi në konsideratë faktin se punëdhënësi është publik dhe të ardhurat kanë kaluar me bankë, e është e pamundur ta fshehësh. Gjithsesi, konsolidimi i mëtejshëm i vendimarrjes së KPK apo edhe vendimet e ardhshme të KPA-së mund të përkufizojnë më qartë fshehjen e pasurisë dhe nga e dallon nga pasaktësia e deklarimit apo mangësi në deklarim.

Në Vendimin 17, datë 04.06.2018, konstatohet nga trupa e KPK (fq. 15 e Vendimit) se *'sa u përket të ardhurave të përfituara nga 'puna në të zezë', i punësuar nuk mund të angazhohej në një marrëdhënie të paligjshme për të krijuar kurse të mëdha, pasi ato mund të mbulojnë vetëm nevojat ditore. Në këto kushte, Komisioni gjykon se të ardhurat e pretenduara nga bursa dhe puna në të zezë nuk janë burime të bindshme për justifikimin e kësaj pasurie'*. Ky konstatim lidhur me *'punën në të zezë'* dhe angazhimin në të për të fituar mjete monetare vetëm për të mbuluar nevojat ditore nuk është i qartë lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të ri-vlerësimit apo të subjekteve të lidhur me të, pasi individët mund të përfshihen në marrëdhënie të paligjshme apo *'punë në të zezë'* edhe për sasi të mëdha mjetesh monetare.

3.27 Mospërputhja e të dhënave të organeve ndihmëse me të dhënat e hetimit administrativ të KPK (referuar analizës së vendimeve të KPK-së)

Roli i organeve ndihmëse në procesin e vettingut është shoqëruar me diskutime për funksionin e këtyre organeve lidhur me hetimin, vlerësimin dhe vendimarrjen e KPK apo KPA, për kriterin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale.

Në dy prej vendimeve të studiuara është vërejtur që rezultatet e organit ndihmës ILDKPKI nuk janë përputhur me rezultatet e hetimit administrativ që janë kryer nga KPK⁵⁹. Në disa raste KPK ka kërkuar rishikimin e raporteve të organeve ndihmëse, të cilat në raportin e dytë kanë përmbysur konkluzionet e raportit të parë, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm për pastërtinë e subjekteve. Gjithashtu, vihet re që KPK kryesisht ka kryer një hetim të gjerë administrativ dhe nuk është mjaftuar vetëm me raportet e organeve ndihmëse, duke arritur në përfundim të këtij hetimi në një konkluzion të ndryshëm nga ai i organeve ndihmëse. Madje në disa raste, të dhënat në deklarinim e pasurisë në kuadër të vettingut janë krahasuar nga KPK me të dhënat në kuadër të deklarimeve periodike që subjektet kanë kryer pranë ILDKPKI-së gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, duke arritur në përfundimin se ka pasaktësi dhe mospërputhje mes këtyre deklarimeve.

KPK, në analizën e të dhënave të organeve ndihmëse i është referuar gjithashtu edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 2/2017 (analizuar më herët në këtë raport). Kjo është pozitive për të krijuar precedent lidhur me statusin e organeve të vettingut si KPK dhe KPA në raport me organet tradicionale që nuk kanë kompetenca vendimmarrëse por ndihmojnë në vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si ILDKPKI, DSIK dhe KLD/Prokuroria e Përgjithshme.

3.28 Vendimmarrja e KPK-së (konfirmimet/shkarkimet)

Sikurse është vërejtur më sipër, KPK ka disponuar me vendim deri në fund të muajit Qershor 2018, për 27 subjekte të rivlerësimit, ku në 12 raste vettingu është ndërprerë për shkak të dorëheqjes, në 9 raste është vendosur konfirmim në detyrë dhe në 6 raste shkarkim nga detyra. Deri në fund të muajit Qershor 2018, KPK ka publikuar vendime të arsyetuara për 21 subjekte, prej të cilëve, për 12 është ndërprerë procesi i vettingut, 5 janë shkarkuar dhe 4 janë konfirmuar në detyrë.

KPK ka respektuar afatin ligjor 30 ditor, për arsyetimin e vendimeve, afat i cili fillon nga data e shpalljes së dispozitivit⁶⁰. Megjithatë, vëzhguesit e KShH-së kanë rekomanduar që në faqen zyrtare të KPK-së të vendoset tek rubrika e publikimit të vendimeve, përbri çdo vendimi, data e publikimit të vendimit të arsyetuar, çka mundëson një monitorim më strikt të respektimit të këtij afati.


⁵⁹ Shih vendimet nr. 15, datë 20.04.2018 dhe nr.19, dt. 14.05.2018

⁶⁰ <http://kpk.al/vendime/>

Nga analiza e pesë vendimeve të arsyetuara, ku është dhënë masa disiplinore e shkarkimit vërehet se shkaku/shkaqet konkrete që justifikojnë shkarkimin sipas KPK-së në zbatim të nenit 61 të ligjit nr.84/2016 janë si vijon:

- » 2 raste⁶¹ – për pikën 1 dhe 3 të nenit 61, përkatësisht se **“rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”** dhe se **“rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e Pasurisë”**;
- » 2 raste⁶² – për pikat 3 dhe 5 të nenit 61, përkatësisht se **“rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”** dhe **“se nga vlerësimi tërësor, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”**;
- » 1 rast⁶³ – për pikën 3 të nenit 61, **“rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”**.

SHKAQET E SHKARKIMIT NË VENDIMET E ARSYETUARA TË KPK-SË



Në pjesën arsyetuese të vendimmarrjes së KPK rezulton se subjektet janë shkarkuar në shumicën dërmuese për komponentin e pasurisë, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, deklarimit të rremë ose të pasaktë, apo deklarimit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme. Vetën në një rast, rezulton se paralelisht me komponentin e pasurisë, subjekti është dorëhequr sepse janë gjetur të bazuara denoncimet e publikut, çka kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

⁶¹ <http://kpk.al/wp-content/uploads/2018/05/Vendimi-FINAL.pdf>, file:///C:/Users/USER/Documents/Vetting/Vendimet%20e%20Shkarkimit/KPK-Vendimi-Fatos-Lulo-23032018-Njoftuar-Anonimizuar.pdf ,

⁶² Për subjektin AXH, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese, vendimi Nr. 17, dt. 04.06.2018

⁶³ file:///C:/Users/USER/Documents/Vetting/Vendimet%20e%20Shkarkimit/vendim-Fatmir-Hoxha.pdf

3.29 Kallëzimet në prokurori nëse gjatë vettingut zbulohen të dhëna/fakte/prova që përbëjnë vepër penale

Sikurse dihet, vettingu është një proces *sui generis* me natyrë administrative, i cili nuk ka si qëllim të ndëshkojë penalisht gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen atij, por në përfundim të tij vendoset konfirmimi në detyrë, shkarkimi nga detyra ose pezullimi nga detyra për një periudhë një vjeçare. Megjithatë, institucionet e rivlerësimit kanë detyrim të bëjnë kallëzim në prokurori, nëse gjatë procedimit administrativ, zbulojnë të dhëna, fakte apo prova që përbëjnë vepër penale që ndiqet kryesisht.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të KPK-së⁶⁴, rezulton se, në bazë të nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, ka referuar pranë Zyrës së Prokurores së Përgjithshme të gjithë dokumentacionin që rezultoi nga hetimi administrativ gjatë procesit të rivlerësimit të ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të dorëhequr (me iniciale B.I.). Ky rezulton të jetë njoftimi i vetëm për referimin e materialeve të hetimit administrativ në organin e prokurorisë. Sipas komunikimit që KShH ka pasur me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se për këtë kallëzim me nr.3671 është vendosur në dt. 03.04.2018 mos fillim i hetimeve dhe vendimi i është njoftuar palëve të interesuara.

KShH, duke pasur parasysh numrin e dorëheqjeve dhe rasteve të vendimeve për shkarkim për shkak të kriterit të pasurisë, i është drejtuar me kërkesë për informacion Prokurorisë së Krimeve të Rënda si dhe Prokurorisë së Rretheve Gjyqësore për veprat penale që ato kanë në kompetencë lëndore dhe territoriale, nëse në kuadër të procesit të vettingut është paraqitur ose jo nga KPK kallëzim penal në referim të nenit 281/pika 1 e K.Pr. Penale për ato subjekte që është ndërprerë procesi si rezultat i dorëheqjes apo për të cilat është vendosur shkarkimi. Shumica e prokurorive të kontaktuar i janë përgjigjur kërkesës zyrtare për informacion të KShH-së. Në të gjitha rastet, me përjashtim të rastit të sipërpërmendur rezulton se nuk ka pasur kallëzime të tilla penale.

⁶⁴ <http://kpk.al/2018/03/20/njoftim-5/>

4. REKOMANDIME

Rekomandimi 1: I sugjerojmë KPK-së të vijojë me ritme dinamike zhvillimin e seancave dëgjimore për subjektet prioritare dhe më pas për subjektet e tjera, duke angazhuar trupat gjyquese në zhvillimin e seancave paralele por që nuk krijojnë mbivendosje përgjatë një jave kalendarike

Për shkak të rëndësisë dhe vëllimit të procesit të vettingut, i cili parashikon rivlerësimin kalimtar të rreth 800 subjekteve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është në dijeni se ky proces është kompleks dhe i vështirë. Megjithatë, KShH gjykon se ky volum i lartë pune kërkon veprimtari me ritëm më të shpejtë dhe më dinamik nga institucionet e pavarura kushtetuese të vettingut, pa ndikuar cilësinë e procesit të vettingut.

Rekomandimi 2: Sugjerojmë të rishikohet struktura dhe organika e personelit të institucioneve të vettingut, me qëllim që ti përgjigjet ngarkesës reale të këtyre institucioneve.

Rekomandimi 3: Sugjerojmë të vazhdojë vëzhgimi dhe vlerësimi publik i vettingut, por pa cenuar dinjitetin njerëzor të subjekteve. I sugjerojmë institucioneve të vettingut të sigurojnë transparencë të plotë në seancat dëgjimore dhe vendimmarrjet e tyre.

Vëzhgimi dhe aksesimi i publikut dhe i medias në seancat dëgjimore duhet të vijojë konform standardeve pozitive të vendosura në praktikën e deritanishme të institucioneve të vettingut.

Duke qenë se OMN nuk publikon komente dhe raportin vetëm brenda saj, do të sugjerohet që publiku të njihet me rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë në vendimet e institucioneve të vettingut.

Rekomandimi 4: Sugjerojmë të rishikohet në Rregulloret e KPK-së dhe KPA-së për marrëdhëniet me median, kufizimi që është vendosur për regjistrimin audio-viziv pas çeljes së seancës dëgjimore, i cili në vlerësimin tonë nuk është në përputhje me kërkesat e lirisë së shprehjes të sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e RSH-së.

Rekomandimi 5: Sugjerojmë të organizohen trajnime të vazhdueshme për aspekte të rëndësishme të zbatimit të legjislacionit të vettingut për të cilat nevojitet rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Organeve të Vettingut, si p.sh. sa i takon shkrimit dhe arsyetimit të vendimeve.

Rekomandimi 6: Sugjerojmë që institucionet e vettingut⁶⁵ të realizojnë një komunikim pro-aktiv me qytetarët dhe ti informojnë ato mbi ecurinë e shqyrtimit të denoncimeve të tyre.

Duke qenë se reforma në drejtësi u iniciua dhe u realizua duke pasur në konsideratë nevojat dhe ankesat e qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë, është e kuptueshme që shumica e qytetarëve kanë ankesa të lidhura me themelin e çështjeve të hetuara dhe të gjykuara dhe rrjedhimisht të pretendojnë vendime të padrejtë nga prokuroria dhe gjykata.

KShH vlerëson se mund të nevojitet një hetim i specializuar i çdo ankese, e cila mund të evidentojë qoftë tërthorazi apo edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, elementë të lidhur me aspektin e aftësive profesionale, pasurisë apo figurës për subjektet e vettingut ndaj të cilëve është paraqitur ankesa.

I sugjerojmë IKP dhe KPA-së të publikojnë numrin e rasteve të denoncimeve të publikut të administruara dhe të shqyrtuara prej këtyre institucioneve.

Sugjerojmë që praktika pozitive KPA-së të ndiqet edhe nga dy organet e tjera të vettingut, përkatësisht për informimin zyrtar në çdo rast të denoncuesit, për trajtimin dhe shqyrtimin e denoncimit të tij/saj.

Rekomandimi 7: I sugjerojmë organeve të vettingut të publikojnë në faqet e internetit të dhëna statistikore periodike dhe të përditësuara, për numrin e subjekteve dhe rezultatet e procesit në mënyrë periodike.

Rekomandim 8: Pavarësisht nga mënyra e organizimit dhe e ndarjes së punës në trupa gjyquese, i sugjerojmë KPK-së që bazuar në nenin 4, pika 5 të ligjit nr.84/2016 të ushtrrojë funksionet duke respektuar parimin e barazisë përpara ligjit.

⁶⁵ Me anë të punonjësve të pritjes së qytetarëve/ankesave

Rekomandimi 9: Çdo person, pavarësisht nga pozita zyrtare apo statusi publik, sugjerojmë që të shmangë format e reagimit që mund të perceptohen si ndërhyrje e qoftë e tërthortë në veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit apo në veprimtarinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që po i nënshtrohen vettingut.

Rekomandimi 10: I sugjerojmë trupave gjyquese të KPK-së që në përfundim të hetimit administrative, të vendosin në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit një afat sa më të arsyeshëm për të paraqitur prova shitesë, komente, shpjegime dhe mendime rreth tyre (si p.sh. minimalisht 10 ditë).

Rekomandimi 11: I sugjerojmë trupave gjyquese të KPK-së dhe përfaqësuesve të ONM-së të respektojnë në deklaratimet/disponimet e tyre, të drejtën e subjektit për tu mos u paraqitur në seancë, kur interesat dhe të drejtat e ligjshme të tij/saj mbrohen nga avokati prezent në seancën dëgjimore, i autorizuar për ta përfaqësuar subjektin edhe në mungesë të tij/saj.

Rekomandimi 12: Për një akses sa më të lehtë në gjetjen dhe leximin e vendimeve të KPK, do të sugjeronim lista e vendimeve të KPK të shfaqet e plotë në një faqe të vetme të internetit që mundëson përdorim sa më praktik të saj nga të gjithë të interesuarit, duke vendosur në këtë rubrikë numrin e vendimit, datën e publikimit të vendimit të arsyetuar në këtë faqe, edhe me identitetin e subjektit, si dhe funksionin që mbante para procesit të ri-vlerësimit,

Ky raport prezantohet në vijim të monitorimit të realizuar në kuadër të nismës “Për të rritur transparencën, gjithë përfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e vettingut”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).